

UNITED NATIONS
United Nations
Interim
Administration
Mission in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

KUVENDI I KOSOVËS СЕВТИЛИТНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

BULETINI

Shtator, 2003 Nr.2



Zyra për Marrëdhënie me Media dhe Publikime e Kuvendit të Kosovës

U realizuan takime të rëndësishme në Bundestagun Gjerman dhe në Ministrinë e Jashtme

Premtime për mbështetjen e Kosovës me ekspertë ligjorë dhe kushtetues, si dhe për modernizimin e arsimit në Kosovë

Delegacioni parlamentar i Kosovës, i kryesuar nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, Nexhat Daci, u kthye nga një vizitë njëjavore në Gjermani, gjatë së cilës realizoi takime të frytshme në



Nexhat Daci

Bundestagun Gjerman dhe në Ministrinë e Jashtme të këtij vendi evropërendimor. Delegacioni përbëhej nga deputetë (anëtarë të Komisionit parlamentar për Arsim, Shkencë dhe Teknologji), nga ministri i Arsimit, Rexhep Osmani, nga shefat e grupeve parlamentare, Sabri Hamiti e Bujar Dugolli, sekretari i Kuvendit, Isuf Demaj dhe anëtarë të tjerë të stafit.

Delegacioni ka vizituar institucione të rëndësishme shkollore, universitare dhe shkencore të Gjermanisë dhe është njoftuar me përvojat e reformimit të arsimit, sidomos të pjesës lindore të vendit, që për dyzet vjet me radhë ka pasur sistem arsimor të vendeve të Lindjes, të ngjashëm me atë që kishte edhe Kosova.

Kryetari Daci dhe ministri Osmani kanë pasur takime të rëndësishme edhe në Parlamentin e Saksonisë së Poshtme. Si në Berlin, ashtu edhe në Hanover, kryeparlamentarit Daci i është përmtuar mbështetje me ekspertë ligjorë dhe kushtetues, si dhe për reformimin dhe modernizimin e arsimit të Kosovës. Ndërkaq, gjatë vizitës në gjigantin e industrisë automobilistike "Golf", është shqyrtuar edhe mundësia e hapjes së një përfaqësie të kësaj industrie në Kosovë.

Në të kthyer nga Gjermania, në Aeroportin e Prishtinës, profesor Daci u ka deklaruar gazetarëve se në Evropë po ndryshon çdo gjë për së miri në favor të zgjidhjes së çështjes së Kosovës, por vende-vende ende ka hezitime për shkak të pasigurisë, sidomos për atë se çka do të ndodhë me palcat.



PËRMBAJTJA:

Vendosmëri për t'i ndihmuar Kosovës që të bëhet anëtare e plotë e familjes së Unionit Evropian	3
Pavarësia - dhuratë për Krishtlindje	10
Kosovës i duhen ligje që aplikohen në tërë territorin e saj	8
Komunat janë zhveshur tërësisht nga e drejta e posedimit të pronës	10
Të unifikohet sistemi i arsimit në Kosovë	11
Angazhimet e përbashkëta ndihmojnë k thimin	15

Redaksia:

Sherif Konjufca, Shefqet Rexhepi, Celal Ilias

Telefonat Kontaktues:

038\ 211 186, 038\ 211 949, 038\ 211 189, 044\ 127 921

Tel/Fax: 038 211188

E-mail:

media_kuvendi@hotmail.com

Vendosmëri për t'i ndihmuar Kosovës që të bëhet anëtare e plotë e familjes së Unionit Evropian

“Nisja e dialogut do të çonte një porosi shumë pozitive për komunitetin tuaj, do të tregojë se ju jeni udhëheqës që mund të merrni përgjegjësinë mbi vete në një mënyrë shumë konstruktive dhe do të tregonte qartas se kur themi që Kosova është në rrugën drejt Evropës, kjo nuk është për shkak se vetëm gjeografikisht e politikisht jeni pjesë e kontinentit të vjetër, por se jeni mjaft të pjekur për të folur me ata me të cilët nuk pajtoheni në shumë gjëra. Nuk jeni të vetmuar në këtë dialog. UNMIK-u do të jetë në anën tuaj për t’ju përkrahur”, theksoi Kris Paten

Në Seancën e Kuvendit të Kosovës, mbajtur më 11 shtator morën pjesë edhe presidenti i Kosovës Ibrahim Rugova, kryeadministratori i Kosovës Harri Holkeri, kryeministri Bajram Rexhepi, komisioneri i Unionit Evropian për politikë të jashtme, Kris Paten dhe Marice Reis, shefe e Zyrës Amerikane në Prishtinë.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Nexhat Daci pasi përshëndeti mysafirët e lartë dhe të pranishmit

parë në zhvillimin e proceseve demokratike në Kosovë, për një rrugë të suksesshme të përbashkët, edhe pse jo të një dinamike që do të kënaqte popullin e Kosovës dhe bashkësinë ndërkombëtare, tha se sfidat kryesore me të cilat ndeshet Parlamenti i Kosovës janë të dyllorshme: janë të natyrës ekonomike që, edhe katër vjet pas luftës, nuk po arrijmë ta sfundojmë Kosovën dhe ekonominë e saj të tregut me ligjet bazë që do të mundësonin riaktivizimin e resurseve të bollshme të

ato kushtetuese në rajon dhe për Kosovën dhe brenga më e madhe e Kuvendit të Kosovës është në atë që ne ndjejmë si mosreagim adekuat të Brukselit, në veçanti, dhe të Bashkësisë Evropiane.

Prania e zotit Paten dhe zotit Holkeri sot, është një shpresë për Parlamentin e Kosovës, për qytetarët e Kosovës që kjo do të ndryshojë dhe ne, si Parlament, të merremi me sfondimin e ligjeve që krijojnë kushte të barabarta për jetë të qetë të qytetarëve të Kosovës, në një Parlament 14 partish, në të cilin 7 janë minoritare dhe 7 të mazhorancës.

Unioni Evropian ka dhënë më shumë se një miliard euro ndihmë për Kosovën

Në fjalën e vet drejtuar Parlamentit z. Hari Holkeri, pasi përkujtoi se sot shënojmë përvjetorin e dytë të sulmeve terroriste në Nju - Jork dhe në Uashington, theksoi se vrasja e qytetarëve të pafajshëm nga e mbarë bota, ishte një sulm, të cilin terroristët po e bënin mbi civilizimin, sepse i tërë civilizimi ushqen respekt për dinjitetin e qenieve individuale njerëzore dhe janë vlera këto mbi të cilat edhe Organizata e Kombeve të Bashkuara, është themeluar.

Kur ndodhën sulmet e 11 shtatorit, ajo ditë, ishte paraparë të jetë ditë ndërkombëtare e paqes. Në cilësinë time, si kryetar i Asamblesë së mileniumit, isha dëshmitar i këtyre ngjarjeve të tmerrshme nga selia e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Nju - Jork. Para një muaji, Organizata e Kombeve të Bashkuara ka pësuar edhe një shpërthim në selinë e saj në Bagdad, një vrasje nihiliste, kur një vetëvrasës



Harri Holkeri dhe Kris Paten

foli për sfidat që po e përcjellin punën e Parlamentit të Kosovës, për përcaktimin e plotë e të njëmendët të Kuvendit të Kosovës dhe të popullit të Kosovës për zhvillimet demokratike në Kosovë, për kontributin paqes në Kosovë dhe në rajon. Ai pasi shprehu kënaqësinë e Kuvendit të Kosovës për të arriturat e përbashkëta në çlirimin e Kosovës, në rindërtimin e saj dhe në hapat e

Kosovës dhe këtë për arsye të mungesës së kompetencave të mjaftueshme të Qeverisë së Kosovës që të bëjë seleksionimin për sponsorizim të ligjeve që i duhen Kosovës dhe, sfida më e rëndë që po i bëhet Kosovës, është sjellja në fqinjësi dhe në veçanti sjellja e Beogradit në destabilizimin e Kosovës në tërësi, duke bërë agresione të ndryshme dhe, mbi të gjitha,

me autobombë vrau njerëz të pafajshëm. Unë e di se të gjithë ju më bashkëngjiteni në vendosmërinë tonë për të luftuar terrorizmin, ekstremizmin dhe jotolerancën, kudo që ato ndodhin. Ne të gjithë jemi të shokuar nga lajmet e fundit, nga Stokholmi, kur Ana Lind, ministreshë e punëve të jashtme humbi jetën si rezultat i një sulmi brutal.

Në vijim z. Holkeri pohoi: "Unë tashmë jam konsultuar me liderët politik kosovarë dhe po ashtu e mirëpres punën të cilën do ta bëjmë bashkërisht gjatë javëve dhe muajve të ardhshëm. Bashkëpunimi ynë efikas është domethënës për vazhdimin e përpertimeve në Kosovë. Por, as UNMIK-u, as institucionet e Kosovës nuk mund të përfitojnë në kurriz të tjetrit. Realiteti është i atillë që ne jemi partnerë, partnerë në kuptimin më të thellë dhe në këtë vetëm nëse punojmë bashkërisht do t'ia dalim të gjithave me sukses, sepse ne do të jemi partnerë. Kurse, tani kam kënaqësinë që t'i shpreh mirëseardhje, edhe një herë në Kosovë një miku tjetër të Kosovës, zotit Kris Paten, që është komisioneri i Unionit Evropian për politikë të jashtme".

Që nga viti 1999, vijoi Holkeri, Unioni Evropian ka kontribuar dhe ka dhënë më shumë se një miliard euro ndihmë për Kosovën, si dhe Shtylla e Katërt e UNMIK-ut. Unioni Evropian ka marrë rolin udhëheqës për të transformuar ekonominë e Kosovës, ai po ashtu, ka krijuar një mekanizëm të posaçëm që është mekanizmi përcjellës për standardet, i ashtuquajtur i STM që do të përcjellë përmbushjen e standardeve të Kosovës, të cilat do të ndihmojnë në përcaktimin e statusit përfundimtar të Kosovës. Ndihma financiare si dhe vetë ky mekanizëm përcjellës, paraqesin vendosmërinë e Unionit Evropian për t'i ndihmuar Kosovës që të bëhet anëtare e plotë e familjes së Unionit Evropian. Kriteret evropiane për anëtarësim, përfshijnë institucionet demokratike, rend e ligj dhe ekonomi të bazuar në ekonomi të tregut.

Qeveria dhe Kuvendi, gjatë miratimit të 27 ligjeve, mund të them se ka bërë një të arritur të madhe për të krijuar një ambient të mirëfilltë. Qeveria, pothuaj, ka kompetenca në

sfera të ndryshme të jetës së përditshme në Kosovë.

Një gjë që na ka munduar për një kohë të gjatë është dialogu me Beogradin dhe besoj se tani është momenti i përshtatshëm për të shkuar përpara. Qeveria është duke përgatitur programin e saj për bisedimet me Beogradin që do të fillojnë së shpejti.

Por, një fushë, ku përparimi dhe sukseset janë ende të pamjaftueshme, është fusha e kthimit të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në Kosovë.

vazhdohet me vendosmërinë që është shprehur në letërën e hapur. Pra, duhet mënjanuar brutalitetin, i cili pengon në rrugën drejt Evropës.

Të synoni më shumë sesa vetëm ta ndalni ciklin e dhunës

Në vijim Z. Kris Paten tha se kur ka ardhur këtu herën e parë as që ka ëndërruar se një ditë do t'iu drejtohej Kuvendit, udhëheqësve të zgjedhur në mënyrë demokratike këtu në Prishtinë. Ndoshta duhet të vijë një

Të mos ndërmerren veprime të cilat ngrisin tensione

E di se të gjithë jeni të shqetësuar për statusin përfundimtar të Kosovës. Kjo nuk është temë që do të trajtohet sot, mirëpo natyrisht nuk është ndonjë temë që mund të shtyhet pafundësisht. Ajo që është me rëndësi, është që secili, pa marrë parasysh a është në Beograd apo këtu në Prishtinë, duhet të mos ndërmarrë më veprime të cilat ngrisin tensione. Këtë duhet ta bëj plotësisht të qartë edhe nesër në Beograd. Deklaratat parlamentare kundër pavarësisë janë, nëse e themi shumë but, të padobishme. Të tilla do të ishin edhe deklaratat e pavarësisë nëse bëhen këtu. Asnjëra nuk do të kishin ndonjë ndikim më të vogël në vendimin përfundimtar.

Ajo që do ta diskutojmë sot është fillimi i një dialogu të ri e konstruktiv me Beogradin. Ky do të duhet të ishte prioritet, për të gjitha institucionet e Kosovës dhe për UNMIK-un, të nisët dialogu me Beogradin për çështje të cilat kanë të bëjnë me jetën e përditshme të të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Nisja e dialogut do të çonte një porosi shumë pozitive për komunitetin tuaj, do të tregojë se ju jeni udhëheqës që mund të merrni përgjegjësinë mbi vete në një mënyrë shumë konstruktive dhe do të tregonte qartas se kur themi që Kosova është në rrugën drejt Evropës, kjo nuk është për shkak se vetëm gjeografikisht e politikisht jeni pjesë e kontinentit të vjetër, por se jeni mjaft të pjekur për të folur me ata me të cilët nuk pajtoheni në shumë gjëra. Nuk jeni të vetmuar në këtë dialog. UNMIK-u do të jetë në anën tuaj për t'ju përkrahur. Nisma, sikur janë trajnimi i nëpunësve civil, që do të kryhen nën ombrellën e OSBE-së, në bashkëpunim me Institutin e Paqes të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, do t'i ndihmojnë administratës suaj për këtë dhe për shumë sfida tjera, theksoi Paten.

Para disa muajve, liderët kosovarë kanë treguar një guxim dhe trimëri të madhe duke publikuar një letër të hapur me anë të së cilës ftonin pjesëtarët e komuniteteve pakicë të kthehen nëpër shtëpitë e tyre.

Unë e di se miku ynë, Kris Paten, do të pajtohet se shumetniciteti nuk ka ndonjë pengesë dhe nuk duhet të ketë pengesë për krijimin e shoqërisë së mirëfilltë çfarë e synojmë. Prandaj, përkrahja do të jetë e vazhdueshme nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, bashkësia ndërkombëtare, Unioni Evropian që kanë ndihmuar në të arriturat e shumta dhe në shumë sfera.

Por, në mënyrë që Kosova të vazhdojë rrugën e saj drejt Evropës, duhet të bëhet edhe më shumë dhe duhet të

vizitor i cili ua dëshiron të mirën, i cili do të ishte në gjendje të shohë përparimin që e keni arritur ju në partneritet me bashkësinë ndërkombëtare.

Çështja e statusit përfundimtar të Kosovës ende nuk është për diskutim, mirëpo atë që e dimë të gjithë plotësisht qartas është se ardhmëria juaj është në Evropë. Ky ka qenë përkushtimi i krejt Bashkësisë Evropiane në takimin e saj në Selanik, në qershor dhe më vjen mirë që mundem edhe një herë ta konfirmoj atë premtim sot. Vitin e ardhshëm, vendet e Evropës Juglindore do t'i bashkëngjiten familjes sonë evropiane.

/ vijon në faqen 5 /

Para dhjetë vjetësh dukej si një ëndërr në qiell, e perealizueshme, mirëpo tash po shohim zhvillimin e vendeve demokratike, me ndihmën tonë, të cilat po hyjnë në Bashkësinë Evropiane. Ata ia kanë dalë. Këtë mundeni edhe ju.

Roli i këtij Kuvendi është shumë qenësor që të kuptohet kjo e ardhme evropiane për Kosovën. Ju jeni përfaqësuesit e zgjedhur në mënyrë demokratike të popullit, dhe është përgjegjësi juaja që Kosovën ta çoni në rrugën e stabilizimit, demokratizimit dhe modernizimit. Ju jeni këtu për të punuar për mirëqenien e gjithë njerëzve në Kosovë, pa marrë parasysh etninë apo bindjet e tyre politike e shoqërore. Ky Kuvend është forumi i demokracisë kosovare, ku ju diskutoni dhe argumentoni në mënyrë demokratike dhe civilizuese. Nuk do të befasoheshim nëse nganjëherë bëni zhurmë. Zhurma në kuvend, si e dimë të gjithë, është zhurmë e lirisë.

“E di se deri tash, ky

Kuvend, ka bërë shumë”

Ka kaluar një vit prejse kam ardhur herën e fundit në Kosovë, mirëpo i kam ndjekur ngjarjet me interes të madh. Siç kam thënë më herët, ka pasur shumë zhvillime pozitive për të cilat mund të jeni krenar. Mirëpo, ka pasur edhe tragjedi në vazhdimësi, sikur janë vrasjet tash rishtazi të fëmijëve të pafajshëm. Këto ndodhi të tmerrshme nuk janë tragjedi vetëm për viktimat, por për tërë Kosovën. Ato janë njëllë në reputacionin e Kosovës. Dhuna, dëshmitare e së cilës është Kosova, nuk mund të garantojë bashkëjetesën paqësore këtu dhe do të ketë pasoja për tërë rajonin. Pra, ju duhet të bëni krejt çka është e mundur që të ndalni këto sulme dhe kundërsulme. E di se shumë politikanë kosovarë kanë folur kundër këtyre sulmeve, ndaj edhe një herë ju përgëzoj juve që keni bërë këtë si përfaqësues të krejt popullit të Kosovës. Të gjithë ju keni një përgjegjësi të veçantë që pa ekui-voke të dënoni njerëzit e këqinj, të cilët kanë vrarë bashkëkombësit e tyre, apo bashkështetasit e tyre.

Po ashtu, ju nxis që t'i dyfishoni përpjekjet, në mënyrë që fjalët tuaja të përcillen në vepra, që bëjnë

ndryshime. Dhe, duke bërë gjithë këtë, duhet të punoni së bashku me partnerin tuaj të çmuar – Kombet e Bashkuara. Ju dhe UNMIK-u duhet të jeni ambicioz dhe të synoni më shumë sesa vetëm ta ndalni ciklin e dhunës.

E di se deri tash, ky Kuvend, ka bërë shumë. Po ashtu edhe Qeveria, partneri juaj UNMIK-u, por realiteti tregon se duhet bërë shumë më shumë, jo vetëm nga ju që jeni në qendër këtu në Prishtinë, por kjo vlen për çdo komunë anëmbanë Kosovës. Nuk ka ndonjë detyrë më të rëndësishme për Kosovën, e cila dëshiron të demonstrojë se është e përkushtuar për një të ardhme paqësore demokratike.

Bashkësia ndërkombëtare, miqtë tuaj në Amerikë, miqtë tuaj në Evropë, të cilët janë plotësisht me një mendje lidhur me këto çështje – nuk mund t'ju japin vullnetin politik që t'i çoni sendet përpara, kjo duhet të vijë prej jush. Ka një dallim në mes asaj të jesh në gjendje të ndihmohesh diçka dhe të ulesh vetë në tavolinë. Ne do t'ju përkrahim në mënyrë aktive në dialogun tuaj, sepse jemi shumë të përkushtuar për rajonin e Ballkanit Perëndimor. Këtë e kemi dëshmuar shumë me ndihmën financiare të bollshme, si dhe me përfshirjen tonë politike. Jo vetëm që dëshirojmë të jemi pjesëtarë të dialogut, sepse duam t'ju ndihmojmë, mirëpo, po ashtu për shkak se si Bashkësi Evropiane kemi një përvojë të madhe për krijimin e koncensusit në mes palëve të cilat kanë dallime drastike, e po ashtu, sepse kemi interes të madh që të sigurohemi se ky rajon do të shkojë kah Bashkësia Evropiane, në një mënyrë paqësore e demokratike.

Reformat janë përgjegjësi
juaja

Implementimi i reformave të ngjashme me ato në rajon do t'ju çojë më afër Evropës. Ju do të mund të përfitoni nga përparësitë e bashkëpunimit rajonal, i cili tashmë ka filluar në Evropën Juglindore. Një shembull i qartë është Marrëveshja e tregtisë së lirë që UNMIK-u tashmë e ka nënshkruar me Shqipërinë, nën ombrellën e

Paktit të Stabilitetit. Pjesëmarrja në këtë rrjet marrëveshjesh do t'ju përmirësojë qasjen në tregje dhe do ta bëjë Kosovën shumë më tërheqëse për investitorë. Për këtë qëllim, Bashkësia Evropiane, këtë vit, së bashku me ju, me institucionet e përkohshme dhe UNMIK-un, një mekanizëm përcjellës, që e përmendi edhe zoti Hollkeri, është që t'ju udhëzojë dhe afrojë në Bashkësinë Evropiane, nëpërmjet një procesi i cili, të jam i sigurtë, do të jetë shumë i vështirë.

Më vjen shumë mirë që kam dëgjuar për angazhimet e mëdha personale të kryeministrit dhe ministrave që kanë bërë lidhur me këtë. Ju keni parë rëndësinë, si afatgjatë, ashtu edhe afatshkurtër të këtij procesi, që në të njëjtën kohë do t'ju ofrojë edhe një vlerësim se ku qëndron një Kosovë dhe njëlloj harte se nga duhet të shkoni.

Reformat janë përgjegjësi juaja. Unë dëgjova se jeni në rrugë të drejtë. Më lejoni, për shembull të përmend se sa më ka lënë përshtypje kur dëgjova për ligjin omnibus të antidiskriminimit, që e përpilon Qeveria, duke marrë parasysh standardet evropiane. Mund vetëm t'ju inkurajoj që të vazhdoni në këtë rrugë dhe t'ju siguroj se Bashkësia Evropiane ka qenë dhe do të mbetet e gatshme që t'ju ndihmojë në secilin hap të kësaj rruge. Të përmend, lidhur me këtë, se Agjencioni Evropian për Rindërtim, në mënyrë aktive, i ndihmon Zyrës së kryeministrit, si dhe ministrive të ndryshme me këshilla të ekspertëve, si dhe ka nisur të përkrahë edhe këtë Kuvend me ndihmë për krijimin e një shërbimi administrativ dhe teknik që është qenësor nëse dëshironi të merreni me një punë gjithnjë e më të madhe legislative.

Ju keni një rast të mirëfilltë që t'i tregoni botës se këtu keni qenë në gjendje t'i varrosni armiqtë dhe të kaluarës dhe keni qenë në gjendje të krijoni një ardhmëri e cila është e drejtë për të gjithë, pa marrë parasysh fenë apo etninë, një të ardhme, e cila i vlerëson njëjtë të gjithë, pa marrë parasysh besimet e tyre fetare apo origjinën e tyre, theksoi Paten.

Ofrohen zgjidhje ligjore për zbatimin e regjistrimit të popullsisë

Në Kuvendin e Kosovës është bërë një shqyrtim i gjerë i Projekligjit për regjistrimin e popullatës, ekonomive familjare dhe të banesave. Fjalën hyrëse e mbajti ministri i shërbimeve publike, z. Jakup Krasniqi, i cili tha se ky ligj është njëri prej ligjeve të para që Qeveria e Kosovës ka përcjellë për në Parlament dhe ai ka arritur në Parlament vetëm pas përcjelljes së tretë.

Në bazë të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, Rregullorja e UNMIK-ut 2001/19, Kreu 5, pika 5.1, të datës 15 2001 dhe në bazë të udhëzimit administrativ të Zyrës së Kryeministrit 1/2002, mbi procedurën e përpilimit dhe parashtrimit të ligjeve, Ministria e Shërbimeve Publike hartoi Projekligjin për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave të Kosovës.

Arsyet për nxjerrjen e ligjit për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave të Kosovës, janë të shumta dhe të llojllojshme. Ky ligj do të ofrojë zgjidhje ligjore sistemore për zbatimin e regjistrimit të popullsisë dhe do ta autorizojë Entin e Statistikave të Kosovës të organizojë regjistrimin më 1 prill të vitit 2004.

Nëse qytetarët tanë jashtë vendit nuk përfshihen në regjistrim , atëherë ata do t'i lëmë jashtë mënyrës së identifikimit

Pas hapjes së debatit, **Sabri Hamiti** duke i bërë një vështrim këtij Projektligji, tha se e shoh këtë ligj të një rëndësie të veçantë për zhvillimet shoqërore që do të ndodhin në Kosovë dhe për nevojat e pakapërcyeshme rreth lëvizjeve shoqërore në vendin tonë. Unë, megjithatë, kam një kërkesë që është themelore dhe që e konsideroj të rëndësishme së veçantë, po aq sa është e rëndësishme së veçantë vetë nxjerrja e ligjit. Mua më duket se ligji është restriktiv paarsyeshëm, dhe unë do të përshkruaj objektin e tij duke lexuar nenin 3 a) ku thotë: “Popullsia rezidente duhet të nënkuptojë popullsinë e përbërë nga individët të cilët në ditën e evidentimit ndodhen në territorin e Kosovës, si dhe ata që përkohësisht mungojnë më pak se një vit” dhe neni 7 pika 2 – “Regjistrimi përfshin popullsinë rezidente dhe të gjitha ndërtesat e tjera”. Siç e shihni, të dy këto nene, totalisht lënë jashtë të gjithë banorët e përkohshëm të Kosovës, që jetojnë jashtë, kryesisht në Evropën Perëndimore, që janë rreth 400 mijë. Ju po shihni, unë them rreth 400 mijë, se s’ka njeri të gjallë që e di sa janë, pikërisht sepse s’janë regjistruar. Ju e dini, një provë të viteve të 90-ta, kur institucionet e organizuara të Kosovës bënë përpjekjet për të bërë një regjistrim, i cili është ndalur diku në mes të rrugës dhe nuk është kryer totalisht, domethënë edhe nuk është shpallur publikisht.

/ vijon në faqen 7 /

Struktura demografike dhe karakteristikat kryesore sociale-ekonomike të popullsisë që përmban ligji:

-numrin e përgjithshëm dhe shpërndarjen territoriale të popullsisë së Kosovës;

-numrin dhe shpërndarjen territoriale të popullsisë së Kosovës;

- numrin dhe shpërndarjen hapësinore dhe strukturën e vendbanimeve dhe të ndërtesave të shfrytëzuara me qëllim banimi dhe dedikime tjera;

kushtet e banimit dhe standardet jetësore të popullsisë.

Pra, qëllimi i regjistrimit të popullsisë dhe ekonomive familjare në Kosovës, është sigurimi i të dhënave përmes vrojtimit të plotë mbi banesat dhe karakteristikat socio-ekonomike dhe demografike të popullsisë dhe analizimi e shpërndarja e të dhënave të shfrytëzuesve të interesuar në institucionet shtetërore dhe atyre publike e private.

Nëpërmjet këtij ligji do të bëhet regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë, në mënyrë valide, sepse regjistrimi i vitit 1991, i organizuar nga Enti Statistikor i Jugosllavisë ishte specifik, duke pasur parasysh se popullsia shqiptare e Kosovës refuzoi regjistrimin nga ana e pushtetit ilegal.

Në kapitullin e parë, përshkruhen dispozitat e përgjithshme; qëllimi i organizimit të regjistrimit; objekti i ligjit; autoriteti i regjistrimit; data; perioda e evidentimit; subjekti, si dhe rezultatet e regjistrimit me regjistra statistikor.

Kapitulli i dytë, përmban kompetencat dhe raportet e organeve kompetente përgjegjëse për regjistrim, përkatësisht Komisioni qendror i regjistrimit dhe organet tjera qendrore dhe komunale. Në kapitullin e tretë, përcaktohet obligimi i Qeverisë, i Ministrisë së Shërbimeve Publike, i Ministrisë së Financave dhe i Entit Statistikor të Kosovës, të bëjnë përgatitjet për regjistrimin dhe t’ia dërgojnë Kuvendit të Kosovës për miratim. Në kapitullin e katërtë, përcaktohen procedurat e regjistrimit, publiciteti i medive gjatë fushatës, si dhe obligimi i të gjitha institucioneve që të jenë në shërbim për realizimin e regjistrimit, theksoi ministri Jakup Krasniqi.

Ky është një problem shumë-shumë i madh, esencial për Kosovën, sepse kemi një masë të madhe të popullsisë që jeton përkohësisht jashtë, punon ose s'punon jashtë dhe nëse ne i lëmë jashtë regjistrimit, ne do t'i lëmë jashtë mënyrës së identifikimit, jashtë përkatësisë, jashtë funksionimit të tyre me vendin e tyre, që është një situatë shumë-shumë e rrezikshme, do të thosha unë.

Prandaj, unë propozoj që, ose brenda këtij ligji, duke filluar nga titulli, të thuhet: Regjistrimi i popullsisë me banim të përhershëm në Kosovë dhe i popullsisë që banon përkohësisht jashtë, ndërsa me disa nene të rregullohet kjo materie këtu, ose, nëse jo, atëherë të premtohet këtu se do të hartohet një ligj i veçantë për atë regjistrim atje.

Dhe, gjithnjë lidhur me këtë, unë po ndalem te dy terma që janë terma tash themelore dhe çelës për materien e këtij ligji dhe një materie që mungon nga ky ligj. Thuhet "rezident". Ju lutem shumë, shqip s'thotë kurrëgjë – rezident dhe jorezident. Këto janë terma të marrura. Shqip është shumë e qartë – banor i përhershëm i Kosovës dhe banor i përkohshëm jashtë. Jorezident i bie, nëse e përkthejmë drejtpërdrejt shqip, si: i pashtëpi. Unë po them që njerëz-



it e Kosovës që janë jashtë nuk mund t'i lëmë të pakujdesje, të paatdhe dhe të pайдentitet qytetar e shtetëror.

Ismajl Kurteshi, theksoi se Grupi parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, angazhohet që të sigurohet një ligj i depolitizuar, që i plotëson standardet profesionale, nëpërmjet të cilin do të sigurohet një regjistrim profesional, që do ta pasqyrojë realitetin kosovar e do të mundësojë marrjen e vendimeve të drejta në të gjitha lëmenjtë, pasi që funksioni primar i statistikës është pasqyrimi i realitetit, por edhe zgjidhje e problemeve të lidhura me regjistrimin.

Në Kosovë jetojnë mijëra qytetarë, të shpërngulur para disa viteve nga Lugina e Preshevës, nga Maqedonia e nga vise të tjera dhe ata, edhe pse këtu paguajnë kontributet, këtu shkollohen, punojnë e jetojnë, këtu e kanë edhe pasurinë e tyre, ende nuk kanë mund të nxjerrin dokumente personale. Me vështirësi të ngjashme po ballafaqohen edhe shumë punëtorë tanë në botën e jashtme, të cilët

janë të lidhur me Kosovën, e kanë pasurinë këtu dhe vazhdimisht ndihmojnë ose investojnë në Kosovë. Pra, edhe pse janë ngusht të lidhur me Kosovën, trajtohen si të huaj dhe detyrohen t'i përdorin dokumentet e huaja dhe nuk mund t'i shfrytëzojnë të drejtat që i shfrytëzojnë qytetarët tjerë të Kosovës. Në anën tjetër, qytetarët e pandërgjegjshëm, të ndihmuar edhe nga matrapazë e shërbime të caktuara të administratave lokale, me dokumente të falsifikuara e të nxjerra në Serbi, jo vetëm që sigurojnë dokumente personale, por me dokumente të tilla bëjnë edhe bartjen e pronës. Ne mendojmë që, para se të fillojë regjistrimi, është e rëndësishme të përfundojë edhe emërtimi i rrugëve, lagjeve dhe vendbanimeve të Kosovës, në mënyrë që qytetarët e Kosovës, pas regjistrimit, t'i kenë edhe adresat e tyre.

Dragisha Kërstoviq tha se ka vërejtje thelbësore parimore në Projektligj. Sa i përket qëndrimit të koalicionit "Kthimi" dhe të popullsisë së bashkësisë serbe ky ligj, ashtu si është dhënë, është i papranueshëm. Megjithatë nuk vë në dilemë rëndësinë e këtij ligji për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjeve dhe banesave, Kosova duhet të ketë një ligj të tillë, por duhet të ketë një tjetër lloj ligj, e jo sikurse është dhënë në këtë projekt. Vërejtja ime e parë, që e përsëris shpesh, është se me rastin e përpilimit të këtij ligji dhe të atij që pak më herët e patëm në rend të ditës, nuk marrin pjesë ekspertët serbë. Do të thotë kjo praktikë po përsëritet. Qeveria po bëhet e shurdhër, madje Qeveria qartas ka për qëllim që rreth këtyre çështjeve të mos angazhojë cilindo ekspert për të marrë pjesë në përpilimin e ligjeve, të cilat do t'i aprovojë Kuvendi. Vërejtja ime e dytë ka të bëjë me nenet që pati para sysh Sabri Hamiti, por zotëri **Sabri Hamiti** shprehu shqetësimin për ata mijëra veta nga bashkësia nacionale shqiptare që në këtë çast janë në botën e jashtme, që është e vërtetë, por unë shpreh shqetësimin për ata mijëra serbë, të cilët deri në vitin 1999 kanë jetuar në Kosovë e Metohi, kurse tash jetojnë jashtë Kosovës.

Duke iu kundërpërgjigjur një pjese të fjalës së parafolësit, Sabri Hamiti theksoi se zotëriu, që foli pas meje, më zuri në gojë dhe u përpoq ta interpretojë bisedën që e thashë unë. Njëri, këtu i Kryesisë, po thotë, domethënë, - e ka përkrahur atë. Nuk e ka përkrahur, por e ka interpretuar. Unë e di shumë mirë çka flas saktësisht. Kurrfarë përcaktimi nacional unë nuk kam dhënë, as shqiptar, as serb, as magjup, as egjiptas, as kurrfare. Unë kam thënë: "Njerëzit që janë qytetarë të Kosovës dhe banojnë përkohësisht jashtë". Prandaj, unë e di çka them dhe pse e them. Interpretimi është paragjykses, sepse zotëriu mendon se unë flas vetëm për shqiptarët, e ai e ka detyrë veç për serbët.

Mbyllet një kapitull e regjistrimit të popullsisë sipas interesave të caktuara politike të kohërave të shkuara

Fetije Këpuska theksoi se regjistrimi i popullsisë së Kosovës shtrohet natyrshëm si një punë e ngutshme dhe

e domosdoshme, pikësëpari nga fakti se një regjistrim i tillë nuk është bërë qe më shumë se 20 vjet . Shkaqet pse ka ndodhur kështu, janë të njohura për të gjithë, prandaj edhe nuk do t'i prezentoj. Siç dihet, regjistrimet e këtilla në vendet e botës, bëhen rregullisht së paku në çdo dhjetë vjet . Ç'është e vërteta, deri tash, në bazë të metodave të ndryshme statistikore dhe demografike, janë prezentuar shënime aproksimative nga organizatat dhe institucionet e ndryshme për numrin e përafërt të popullsisë së Kosovës, por që nuk mund të jenë as të sakta e as zyrtare. Një regjistrim gjithpërfshirës i popullsisë, i ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë, do të siguronte bazën e të dhënave zyrtare shumë të çmuara, shumë të domosdoshme, si për punën e banesave, po ashtu edhe për përkatësinë e popullatës, sipas gjinisë, moshës, etnisë dhe rajonit. Regjistrimi do të pasqyrojë realisht, pos numrit të banorëve edhe gjendjen e tyre sociale, materiale, strukturën e saj, numrin e shkollarëve, të punësuarve, të papunësuarve, të pensionistëve – pra do të ishte një statistikë gjithpërfshirëse sipas kategorive dhe shtresimeve të popullsisë apo, siç e quajnë sociologët , sipas stratifikimeve sociale.

Naim Maloku, pasi në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës çmoi lart rëndësinë e sjelljes dhe të miratimit të këtij ligji për Kosovën, tha se në shekullin e kaluar është manipuluar dhe kryesisht janë keqpërdorur të dhënat për popullsinë e Kosovës, janë keqpërdorur për qëllime të ndryshme politike dhe kryesisht në kurriz të popullatës shqiptare. Është manipuluar edhe me përkatësinë etnike, edhe me përkatësinë fetare, edhe me përkatësitë tjera, do të thotë gjinore e tjera. Ligji është shumë i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të Kosovës, sepse në bazë të të dhënave që mirren me regjistrimin e popullsisë, bëhet edhe planifikimi i zhvillimit ekonomik të Kosovës, planifikimi hapësinor i Kosovës : Ministria e Arsimit nxjerr planin për zhvillimin e arsimit, pra

në të gjitha sferat dhe lëmenjë e shoqërisë krijohet bazë për krijimin dhe formimin e planeve dhe për zhvillimin e të gjitha sektoreve nga të dhënat që dalin me regjistrimin e popullsisë. Mendojmë se më në fund ka ardhur koha dhe momenti kur duhet të dijme se sa banorë jetojnë në Kosovë, duke përfshirë këtu edhe përqindjen e popullsisë etnike, fetare e tjera, e tjera.

Ligj që avancoon edhe pozitën e shtetësisë së Kosovës

Ramadan Kelmendi theksoi se një ndër ligjet që avancoon edhe pozitën e shtetësisë së Kosovës, është edhe ky Propozimligj, i cili do të bëjë të mundur regjistrimin e popullsisë, ekonomisë familjare dhe banesore në Kosovë. Ky ligj do të jetë i pari që do ta ketë Kosova, me të cilin do të mbyllet një kapitull i regjistrimit të popullatës sipas interesave të caktuara politike të kohërave të shkuara. Megjithatë, mendoj se para të fillojë zbatimi i këtij ligji, i cili ka rëndësinë dhe peshën e vet, duhet patjetër të kemi të miratuar ligjin mbi emërtimin e vendbanimeve në Kosovë, ngase pa këtë vërtetë emërtimet do të shkaktojnë probleme në regjistrim.

Regjistrimi i popullsisë dhe ekonomisë familjare do të qetë në shesh regjistrimet e Entit Statistikor të Serbisë të vitit 1991, si regjistrime specifike që i shërbyen, thashë më parë, një politike të një regjimi të caktuar, duke bërë përpjekje për ta ndërruar strukturën e popullatës në Kosovë dhe për t'i paraqitur qëllimet tanimë të njohura. Megjithatë, në këtë fazë të aplikimit të këtij ligji do të kemi pengesa nëse nuk arrihet që drejtoritë kadastrale komunale dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës nuk do t'i kenë dokumentacionet e nevojshme për regjistrimin, pasi që shumë dokumente të tilla nuk gjenden në duart e tyre, meqë janë grabitur .

Para se të fillojë regjistrimi i banesave, duhet sqaruar raportin në mes bartësit të vërtetë të së drejtës bane-

sore dhe shfrytëzuesve të banesave, kur dihet se që nga viti 1990 një numër i madh i shqiptarëve, e ai është 158.000, është dëbuar nga puna dhe me këtë ka humbur të drejtën banesore, siç është quajtur.

Rrustem Ibishi, theksoi se deputetët e grupit të bashkësive të tjera këtë projekt e vlerësojnë shumë të thatë, i cili në mënyrë shumë joprecize definon materien. Para çdo regjistrimi të popullsisë , ashtu si është praktika në botë, është e nevojshme të dihet cilat popullsi do të konsiderohen popullsi të një vendbanimi ose rajoni. Ekzistojnë dy kategorie të kuptimeve të popullsisë së përgjithshme: e para popullsi e përhershme, ndërsa e dyta popullsi e pranishme. Popullsi e përhershme – rezidenciale , termi gabimisht po përdoret, të një rajoni konsiderohetn të gjithë ata persona të cilët në atë rajon kanë pasur vendbanimin e përhershëm , pa marrë parasysh se në momentin e regjistrimit kanë qenë të pranishëm , apo nuk kanë qenë .

Mahir Jakxhillar gjithashtu e vlerësoi të një rëndësie të veçantë këtë ligj, duke shprehur besimin se do të kemi një regjistrim sipas parimeve demokratike. Dihet se në vitet 51, 61, 71, 81 dhe 91 janë bërë regjistrime në Kosovë , por ato ishin të kohës së komunizmit, ndaj secili i ka vlerësuar rezultatet ashtu si ka dëshiruar. Ky regjistrim duhet të jetë vërtetë demokratik, ndaj edhe komuniteti turk do ta përkrahë plotësisht. Fjala rezident , tha Jakxhillar, duhet të shpjegohet në mënyrë më precize, sepse nga Kosova në dhjetë vjetët e fundit janë shpërngulur edhe pjesëtarë turq. Me rastin e regjistrimit, theksoi ai, në komisione të regjistrimit duhet të ketë edhe anëtarë nga komuniteti turk, ndërsa formulartët duhet të jenë edhe në gjuhën turke .

Tomë Hajdari tha se në këtë Projektligj, kapitull të veçantë duhet të zërë edhe regjistrimi në sferën agrare të Kosovës.

Kosovës i duhen ligje që aplikohen në tërë territorin e saj

Të pasojë një angazhim edhe më i madh për kthimin e të zhvendosurve, sidomos kur është fjala për ata brenda territorit të Kosovës, u tha në takim Daci - Holkeri

Çështja e sigurisë në Kosovë, kthimi i të zhvendosurve, çështja e të zhdukurve, përgatitjet për fillimin e bisedimeve me Beogradin, si dhe zhvillimi ekonomik i Kosovës, ishin tema qendrore të takimit të kryeparlamentarit të Kosovës Nexhat Daci me shefin e ri të UNMIK-ut, Harri Holkerin, që u mbajt në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës në Prishtinë. Në këtë vështrim u konstatua se është e nevojshme që në të gjitha këto procese të inkuadrohen më shumë vendasit. Kryeparlamentari Nexhat Daci thekoi me këtë rast se Kosova është e sigurt, madje më shumë se disa vende nga më të zhvilluarat në Evropë, gjithsesi falë punës së UNMIK-ut. Mirëpo, rezultatet do të ishin dukshëm më të mëdha, po të angazhoheshin në këto procese edhe më shumë kosovarët. Na duhet një vision shumë i qartë për të ardhmen e Kosovës, sepse çështjet që thuhet edhe në Rezolutën 1244 po na përsëriten që më shumë së katër vjet. Kosovës i duhet ligji, i cili duhet të mbizotërojë në tërë Kosovën, theksoi profesor Daci. Duke shëstuar çështjen e të zhvendosurve, u theksua se duhet të pasojë një angazhim edhe më i madh për kthimin e tyre, sidomos kur është fjala për ata brenda territorit të Kosovës, duke siguruar lëvizje të lirë e të përhershme të



Takimi Daci - Holkeri

qytetarëve.

Për të gjitha këto zhvillime u fol hapur, ndërsa bashkëbiseduesit premtuan bashkëpunim të ndërsjellë. U përkrah fillimi sa më i shpejtë i dialogut Prishtinë- Beograd, sepse bisedimet janë në interes të të dy palëve.” Le të fillojmë me atë që kemi të përbashkët dhe ne kemi mjaft gjëra të përbashkëta në kuptimin evropian e ndërkombëtar. Unë jam i lumtur të konstatoj se elementet për të krijuar diçka të përbashkët këtu janë të dukshme, ekzistojnë”, tha Holkeri.

Profesor Daci bëri me dije se do të përkrahë kryeadministratorin e ri deri atëherë kur është konform arritjes së standardeve për shoqërim në BE dhe në integritet evroatlantike, por nuk do të hezitohet të distancohet në atë periudhë kur ne bashkërisht Kosovës dhe kosovarëve nuk i ofrojmë një vision të qartë. Nga Beogradi po vijnë porosi edhe më të rrezikshme se të etapës së fashizmit në

Ballkan. Unë jam përkrahës i dialogut, sepse më mirë është të pihet një kafe me kundërshtarin më të madh, sesa të luftohet politikisht, ose në mënyra tjera. Por, e thashë për herë të parë, mbase në atë skajshmërinë time, se nuk do ta përkrah dialogun në Bruksel. Brukseli nuk është vend i aspiratave kosovare për dialog, ai është synim yni për t’u integruar në Bashkësinë Evropiane. Brukseli nuk i ka ofruar Kosovës vizion në asnjë peirudhë, as gjatë okupimit, ka qenë Uashingtoni ai, dhe për këtë e kam komplementuar administratën e atëherëshme amerikane dhe dëshiroj që kështu të vazhdohet edhe më tutje. Do të kemi një parneritet me UNMIK-un, do të jemi përgjegjës para elektoratit, sepse bos imi nuk është askush tjetër pos Kosovës dhe kosovarëve. Takimi ishte plotësisht në frekuenca të njëjta që jep shpresë se këto qëllime do të arrihen, theksoi Daci.

Pavarësia - dhuratë për Krishtlindje



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Nexhat Daci, ka pritur profesorin e njohur amerikan të së drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, Paul Williams, i njohur për ndërmjetësime të sukseshme në vendet e konflikteve, si në Bosnjë, Avganistan, Gjorgji etj.

Në takim është biseduar kryesisht për gjasat e dialogut ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit dhe çka mund të presë Kosova nga këto bisedime.

Profesor Williams, i cili përfaqëson institucionin legal të ndërmjetësimit dhe i shfrytëzon përvojat dhe dituritë e ish-avokatëve të Departamentit amerikan të shtetit, në takim me kryeparlamentarin Daci është shprehur se e vetmja zgjidhje për Kosovën është pavarësia dhe ka shtuar se bashkësia ndërkombëtare ia ka marrë Kosovën Serbisë, prandaj duhet t'ua bartë kompetencat institucioneve të vendit.

Profesor Daci nga ana e tij është shprehur se me konstituimin e Kuvendit të Kosovës kishte projektuar vitin 2004 si vit të pavarësisë Kosovës dhe i ishte dukur tepër afër. Sot, ka shtuar Daci, bazuar nga zhvillimet dhe kërkesat, kjo kohë më duket shumë e largët. Mua, ka theksuar kryeparlamentari i Kosovës, pavarësia më duket si një dhuratë për Krishtlindje.

Komunat janë zhveshur tërësisht nga e drejta e posedimit të pronës

Kërkesë thelbësore e Asociacionit të Komunave të Kosovës është që komunat t' i kenë sërish në posedim të gjitha tokat që u kanë takuar më parë atyre, në të cilat nuk ka objekte me rëndësi për privatizim

Komunat e Kosovës pas zhvillimeve të fundit kanë rënë në një situatë paradoksale sa i përket pronave. PSSP i dha autoritet te pakufizuar AKM-së duke i zhveshur komunat tërësisht nga e drejta e posedimit me këto prona. Meqë ekziston vetëm Rregullorja mbi themelimin e AKM-së, por jo edhe Rregullorja mbi mënyrën e trajtimit të pronave, AKM-ja e ka marrë të drejtën e pakufizuar që vetë t' i përcaktojë rregullat dhe vetë t' i zbatojë ato. Në mbështetje të këtij autoriteti të pakufizuar, kjo agjensi ka vendosur që komuna të mos ketë kurrfarë të drejtash të posedimit mbi pronën shoqërore, duke përfshirë objektet dhe pronat. Në këtë mënyrë komunat janë sjellë në atë situatë, kur nuk kanë ku të ndërtojnë shkolla, çerdhe të fëmijëve, parqe për fëmijë, ambulanca, spitale, terrene sportive, pallate të kulturës, biblioteka, galeri të artit, muzeume, parkingje të automjeteve dhe objekte të tjera. Këto ishin disa nga thekset e problemeve që u shtruan nga ana e Lutfi Hazirit dhe Adem Salihajt, në emër të Asociacionit të Komunave të Kosovës, në takimin me kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Nexhat Daci.

Kërkesa e këtij asociacioni është që komunat t' i kenë sërish në posedim të gjitha tokat, në të cilat nuk ka objekte me rëndësi për privatizim, si dhe tokat që janë tepërcë dhe nuk i shfrytëzojnë ndërmarrjet e ndryshme shoqërore dhe publike dhe këto toka t' i destinonjë në përputhje me nevojat dhe kërkesat e qytetit, në kuadër të planit të tyre urbanis-

tik, rural dhe hapësinor që i kanë, apo në bazë të planeve të tyre që mund t' i kenë në të ardhmen. Komunat të jenë faktor i barabartë me të tjerët në çështje të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe publike. Pas privatizimit, fondet nga shitja e objekteve, përveç një pjese, e cila do t' u takonte punëtorëve të ndërmarrjeve të privatizuara, pjesa tjetër t' u mbetet komunave. Ato mjete të përdoren për krijimin e kushteve për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, për rregullimin e infrastrukturës së shkatërruar të komunave, duke përfshirë rrugët, kanalizimin, ujësjellësin, rrjetin elektrik, pastaj për shkollat, spitalet, ambulancat, çerdhet për fëmijë dhe objekte të tjera të rëndësishme për komunën.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Nexhat Daci ofroi mbështetjen e Kuvendit të Kosovës në aktivitetet e këtij asociacioni për të gjetur zgjidhje institucionale në këtë lëmë. Dokumenti që sublimon këtë problematikë, që iu dorëzua në këtë takim kryetarit të Kuvendit do t' i bartet Komisionit për çështje legjislative, gjyqësore dhe Komizë Kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, kurse në shqyrtimet lidhur me këtë problematikë do të ftohet edhe ky asociacion.

Kuvendet e Komunave nëpërmjet Asociacionit të Komunave kanë konfirmuar mbështetjen e plotë ndaj privatizimit në Kosovë, por kërkohet që çështja e rregullimit të pronave të komunave të rishikohet dhe të rregullohet me ligj.

Të unifikohet sistemi i arsimit në Kosovë

Si pikë kyçe e zhvillimit të strategjisë së re, që është duke përgatitur Ministria, është unifikimi i sistemit të arsimit, sigurimi i hapësirës së nevojshme shkollore për të gjitha nivelet, sigurimi i arsimit për të gjithë, arritja e rezultateve të pranueshme të nxënësve në të gjitha nivelet e shkollimit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe inkurajimi i prindërve dhe i shoqërisë në përgjithësi në mbështetje të arsimit, si dhe informimi publik për rezultatet dhe vështirësitë në sistemin e arsimit

Në seancën e 26 qershorit të Kuvendit të Kosovës u bë shqyrtimi i gjendjes së përgjithshme të arsimit në Kosovë. Fjalën hyrëse për këtë temë e mbajti ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Rexhep Osmani, i cili theksoi se Ministria, që nga fillimi veprimtarinë e vet e ka bazuar në një udhëheqje profesionale të sistemit të arsimit, duke sajuar një plan të veprimit, i përqendruar saktësisht se çfarë rezultatesh dëshiron të arrijë në këtë fazë të zhvillimit, me qëllim të përm-bushjes së nevojave për ndryshime.



Kështu, për vitin e parë të veprimit, Ministria e Shkencës dhe Teknologjisë, planifikoi t' i arrijë këto objektiva apo rezultate:

- kompletimin e infrastrukturës në bazë të rregullativës ligjore;
- ndërtimin, zgjerimin dhe renovimin e objekteve shkollore në të gjitha nivelet e shkollimit;
- zbatimin e sistemit të ri të arsimit; e planprogrameve të reja mbi bazën e standardeve ndërkombëtare në të gjitha nivelet e shkollimit;
- hartimin dhe botimin e teksteve mësimore;
- aftësimin e mësimitdhënësve për zbatimin e metodologjive të reja në procesin e mësimitdhënies dhe të mësimitnxënies në të gjitha nivelet;
- pajisja e shkollave me mjete të

- nevojshme mësimore;
- ngritja e qendrave për udhëheqjen e sistemit të informimit në arsim;
- përmirësimin e kushteve për rritjen e vijimshmërisë së nxënësve në shkollë;
- përmirësimin e bazës materiale dhe kushteve të punës për të gjithë punëtorët e arsimit, nxënësit dhe studentët;
- vazhdimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në të gjitha fushat e arsimit;
- zhvillimi i projekteve të ndryshme në zhvillimin e arsimit dhe prezentimin para donatorëve ndërkombëtarë;
- riorganizimi i administratës në institucionet e arsimit, në pajtim me rregullativat ligjore, e tjera.

Ndërsa, si pikë kyçe e zhvillimit të strategjisë së re, që po e përgatit Ministria, është unifikimi i sistemit të arsimit, sigurimi i hapësirës së nevojshme shkollore për të gjitha nivelet, sigurimi i arsimit për të gjithë, arritja e rezultateve të pranueshme të nxënësve në të gjitha nivelet e shkollimit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe inkurajimi i prindërve dhe i shoqërisë në përgjithësi, në mbështetje të arsimit dhe informimi publik për rezultatet dhe vështirësitë në sistemin e arsimit, theksoi ministri Osmani.

REKOMANDIMET

Në emër të Komisionit të Arsimit **Hajredin Kuçi** paraqiti para deputetëve edhe rekomandimet. Kemi kërkuar nga Qeveria, si rekomandim, që të hartojë strategjinë për zhvillimin e sistemit arsimor dhe ajo strategji të miratohet në Kuvend dhe në ndërkohë, duhet të jemi shumë fer, kemi marrë

informata nga Ministria e Arsimit, të cilët kanë përgatitur një strategji të tillë. Ne përgëzojmë për punën, por kërkojmë që ajo strategji të vëhet për diskutim edhe në Kuvendin e Kosovës.



Rekomandimi i dytë: Të unifikohet sistemi i arsimit në Kosovë dhe të hiqen paralelizmat. Ne të gjithë jemi dëshmitarë që në Kosovë ende nuk kemi një sistem të unifikuar dhe kemi sisteme paralele. Kërkojmë nga organet implementuese, respektivisht nga Qeveria, që ta bëjë një gjë të tillë.

Angazhimi i tretë : Qeveria të angazhohet për përmirësimin e gjendjes materiale dhe në afatin prej një muaji, ne kemi menduar një muaj, edhe pse mund të jemi në pushim, të ofrojë një projekt dhe arsyeja është që para fillimit të vitit të ri akademik të dimë gjendjen tonë, të dimë mundësitë tona dhe fillimi të jetë i mbarë. Pra, të mos fillojmë një vit akademik me dilema!

Rekomandimi i katërt : Të nxirret ligji për veprimtari shkencore. Ne e dimë se kemi tash Ligjin për arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë, por ka nevojë që të kemi një ligj që stimulon apo rregullon edhe çështjet shkencore.

Rekomandimi i pestë: Të krijohen standardet bashkëkohore për vlerësim.

/ vijon në faqe 12/

Një konstatim të tillë mund ta gjeni edhe në rekomandimin, apo Raportin e punës së Ministrisë, por mendojmë se, në sistemin tonë arsimor, duhet të kemi një standard bashkëkohor mbi vlerësimin e dijës, mundit dhe angazhimeve tjera.

Kërkesa e gjashtë : Të definohet pozita aktuale e instituteve ekzistuese dhe të stimulohen institutet e reja. Ne kemi shumë institute sot që veprojnë ose nuk veprojnë në Kosovë, të cilat kanë qenë të themeluara, por sot për sot nuk dihet saktësisht qëndrimi i tyre, aktiviteti i tyre dhe mbi të gjitha pozita e tyre.

Është mirë që kjo në një afat të caktuar të definohet: cila është pozita e tyre dhe në qoftë se kemi nevojë për institute shtesë, me siguri se ato duhet të stimulohen edhe nga Qeveria.

Rekomandimi i shtatë: Qeveria të stimulojë bashkëpunimin e institucioneve tona arsimore dhe shkencore me institucionet ndërkombëtare. Në këtë kuptim, mendojmë se duhet të ketë projekte të veçanta, stimulim material sidomos, që institucionet tona përkrah punës së vet, të kenë edhe bashkëpunim të drejtë, korrekt edhe me institucionet tjera ndërkombëtare.

Rekomandimi i tetë: Të bëhet profesionalizimi dhe profilizimi i shkollave të mesme. Besoj se kjo është një nevojë emergjente për tërë sistemin tonë arsimor, sidomos kur kemi parasysh se tani kemi mbi 18 mijë kërkesa për regjistrim në Universitetin e Prishtinës dhe kemi vetëm 5 mijë vende. Kjo nënkupton, në qoftë se kemi shkolla të mesme të profilizuara dhe të profesionalizuara shkolla të mesme, ata do të jenë të aftë për ekonominë e tregut dhe më pak do të gjenin rrugëzgjdhjen e tyre vetëm në Universitet.

Rekomandimi i nëntë : Të vazhdohet me procesin e reformave në Universitet.

Rekomandimi i dhjetë : Qeveria të bashkëpunojë me institucionet arsimore dhe shkencore dhe t' i angazhojë ekspertët për nevoja të veta.

Rekomandimi i njëmbëdhjetë : Qeveria të angazhohet vazhdimisht për shkollat tona, apo për institucionet tona arsimore dhe shkencore që të jenë laike dhe të depolitizuara. Mendoj se kjo çështje është paraparë jashtëzakonisht mirë me ligj, por mendoj se një veprim të tillë duhet ta bëjmë edhe në praktikë.

Rekomandimi i dymbëdhjetë : Të bëhen propozime për ndërtimin e institucioneve të reja arsimore dhe shkencore, në kuptim të ndërtimit të objekteve dhe njëkohësisht për mirëmbajtjen e tyre. Natyrisht, për këtë kërkohet përkrahje edhe nga Kuvendi, do të thotë me siguri me buxhet shtesë, nga se kemi njohuri që nuk mjaftojnë objektet ekzistuese, shkolla filllore, të mesme apo edhe në Universitet.

Rekomandimi i trembëdhjetë : Të bëhet një projekt i veçantë për stimulimin e kuadrove të reja dhe atyre ekzistuese. Në radhë të parë, mendojmë që ka vend dhe hapësirë për kuadro të reja, por gjendja mund të themi edhe materiale edhe tjetër nuk mjafton që të jenë shkollat tona ose Unviersiteti ynë atraktiv, që kuadrove ekzistuese t' u jepet mundësia për ngritjen e tyre permanente.

Në propozimin e katërbëdhjetë është bërë një paksa lëshim. Fjala është që të krijohet këshilli nacional për reforma në sistemin arsimor. Çka kemi menduar me këtë këshill nacional, që emri është i diskutueshëm, mund t'ia ngjesim emrin «Qendra», si t' ua merr mendja. Mendojmë se në Kosovë ka nevojë dhe ka mundësi që të jetë një këshill nacional, i cili do të ishte një organ mbikëqyrës për tërë sistemin arsimor mbi procesin e reformave, nga se ne, besojmë të gjithë, nuk e shohim të shkëputur që nga sistemi parashkollor e deri te Universiteti sistemin e reformave. Pra, të jetë një bashkëpunim, i cili kurrësi nuk do të ishte organ paralel i Ministrisë, por do të ishte një organ i cili do t' i përcillte që nga Kuvendi, që nga Ministria, që nga shkollat në mënyrë permanente reformat, sidomos evaluimin e tyre.

Rekomandimi i pesëmbëdhjetë:

Kemi paraparë të krijohet një fond nacional për përkrahjen e veprimtarive shkencore. Ne e dimë, besoj, të gjithë se kemi raste kur njerëzit tanë dëshirojnë të merren me aktivitete shkencore jashtë ose brenda Kosovës, kanë ftesa njerëzit apo talentët e rinj për shkollim jashtë vendit. Mendoj se duhet të jetë një fond nacional, i cili duhet të përkrahet nga buxheti i Kosovës, por mund të ketë edhe donatorë vendor dhe të huaj, të cilët do të kishin në mënyrë permanente për qëllim përkrahjen e kuadrove, në radhë të parë do të nënkuptonte kuadrot deficitare dhe mendoj se kjo është punë jo shumë e rëndë që mund të bëhet, por do të lehtësonte punën e shumë njerëzve tanë, por njëkohësisht do të përmirësonte edhe kushtet e atyre që dëshirojnë apo do t' u jepte mundësi njerëzve me talent.

Rekomandimi i gjashtëmbëdhjetë: Të bëhen projekte që nxisin aftësitë konkurruese në arsim. Ne mendojmë se në arsim, mbi të gjitha, ka nevojë të bëhen projekte konkrete, që nxisin aftësitë konkurruese në mes studentëve, në mes të nxënësve, por edhe në mesin e vetë mësimitdhënësve.

Afërsi pikëpamjesh

Në vijim mori fjalën shefi i Grupit parlamentar të LDK-së **Sabri Hamiti**, i cili theksoi se pasi dëgjua fjalën edhe të ministrit të arsimit, edhe konkluzionet faktikisht të Komisionit për arsim të Kuvendit tonë, ne pamë këtu një pëlqim gati total të pikëpamjeve, do të thosha unë, dhe kjo më trimëron se kjo fushë me rëndësi të jashtëzakonshme për jetën në Kosovë dhe për të ardhmen e saj do të ketë konsideratën e vërtetë edhe të shoqërisë. Dhe, vetë diskutimi në këtë nivel, në seancë plenare të Kuvendit, po them edhe një herë, na trimëron, sepse shoqëria në përgjithësi në Kosovë do t' i kthehet trajtimin fundamental të



kësaj pjese të jetës sonë, e cila, për shumçka do të jetë determinuese në të ardhmen tonë.

Që në fillim, thashë se i shoh të barasvlefshme pikëpamjet e Ministrisë dhe të Komisionit të Kuvendit. Unë vetëm dua ta përgëzoj Ministrinë për një kujdes, do të thosha unë institucional të artikullimit të kulturuar të pikëpamjeve të veta, të raportit të vet edhe të asaj, që ata e quajnë, strategji. Unë kam në dorë këtu dy dokumente dhe kisha kërkuar që edhe ministritë tjera të komunikojnë me ne në këtë nivel dhe në këtë formë, tha Sabri Hamiti.

Arsim Bajrami, pohoi se kuadrin ligjor e kemi bërë dhe kemi trasuar rrugën për reformimin e arsimit në Kosovë. Por, tani ne duhet që me kritere profesionale, vërtet të ndërtojmë një arsim çfarë i duhet Kosovës. Me këtë rast, gjithmonë duhet të kemi parasysh dy kritere: kriterin e vlerave qytetërore të standardizuara të arsimit që tani po koncipohen në nivel të Evropës dhe kriterin e veçorive të Kosovës. Në Kosovë vazhdon të funksionojë vetëm një institucion publik i arsimit të lartë – Universiteti i Prishtinës, që është themeluar nga Kuvendi i Kosovës. Ky institucion ka pasur jo vetëm vlera akademike arsimore, por ka pasur edhe një vlerë çfarë të gjithë e dimë.

Një çështje tjetër që ne na shqetëson, tha **Bujar Dugolli**, shef i Grupit parlamentar të AAK-së, është çështja e raporteve në mes institucioneve, në këtë rast Ministrisë dhe institucioneve arsimore, duke përfshirë Universitetin, sindikatat e tjera. Të gjithë jemi dëshmitarë se lexojmë



shkrime të ndryshme nëpër gazeta, vlerësime nëpër opinione se këto raporte nuk janë në nivelin e duhur. Qeveria dhe Minsitria duhet ta dinë detyrën e vet siç duhet, t' i dinë edhe institucionet arsimore, Universiteti apo sindikatat. Nuk duhet Qeveria të luajë, apo Minsitria të luajë rolin e tutorit dhe të përzjerjes në autonominë e Universitetit. Unë dëgjova kolegun para meje që tha se Kuvendi i Kosovës ka formuar në vitin 1970 Universitetin!? Po, kjo nuk do të thotë se Kuvendi i Kosovës, në këto rrethana të reja tash, në këtë demokraci që po instalohet në Kosovë, të përzihet dhe të ndërhyjë në punën e institucionit të shkollimit të lartë, në atë organizimin e tij të brendshëm, duke përfshirë edhe sistemin e financimit apo participimit të studentëve.

Në fjalën e saj, **Smilka Milosavleviq**, në emër të grupit parlamentar «Kthimi», theksoi se kur është fjala për arsimin e lartë, ne e kemi licencën për punë në pajtim me autonominë e universitetit, kështu që i hymë reformës së procesit arsimor në pajtim me deklaratën e Bolonjës. Kjo është sa i përket arsimit të lartë. Sa i përket arsimit fillor e të mesëm, jeni në dijeni se vitin e kaluar kemi pasur leje nga PSSP që me reformë të fillojmë një vit më vonë dhe ne këtë e kemi respektuar, kështu që në vjeshtë fillojmë me reformë në kuptim të procesit të arsimit fillor nëntëvjeçar, në pajtim me standardet e pranuar ndërkombëtare.

Sadik Idrizi, në emër të Grupit Parlamentar të bashkësive të tjera vlerësoi se problemet janë të ndryshme nga një bashkësi në bashkësinë tjetër. Ka bashkësi të cilat arsimimin e bëjnë në gjuhën shqipe, si hashkalinjtë etj. që kanë probleme rreth regjistrimit



në fakultet. Pra, kërkojnë diçka si vende plotësuese që si bashkësi t'i fitojnë, kur dihet se atje ekziston konkurrenca, regjistrimi sipas kritereve ekzistuese, por kërkojnë dhe synojnë që në fakultete të kenë vende të caktuara.

Bashkësia rome është e ballafaquar me problemin e arsimit në të gjitha nivelet dhe në këtë drejtim janë të nevojshme orvatjet plotësuese të Ministrisë. Në ekipin e ekspertëve ka qenë i ftuar edhe përfaqësuesi i bashkësisë rome, me qëllim të ndërmarrjes së hapave të parë për futjen e mësimin, gjegjësisht elementeve të kësaj gjuhe për këtë bashkësi.

Sa i përket bashkësisë turke, krahasuar me bashkësitë tjera, ajo është në pozitë më të mirë, sepse ka në të gjitha nivelet e arsimit fillor, të mesëm e fakultete këtu në Prishtinë. Te kjo bashkësi më tepër është i shprehur problemi i dokumentacionit në gjuhën turke, në ato shkolla ku mësimi zhvillohet në këtë gjuhë.

Në Pejë vitin e kaluar është hapur fakulteti i biznesit në gjuhën boshnjake. Në vjeshtë presim hapjen e fakultetit për edukim në Prizren. Mendoj se këtu gjërat janë para përfundimit dhe kemi përkrahjen Ministrisë edhe për gjuhën boshnjake edhe për gjuhën turke.

Reformat kërkojnë energji, por edhe mbështetje materiale

Fatmir Sejdiu tha se ne gjendemi në një proces të reformave që ecën. Reforma që kërkojnë edhe energji, por që kërkojnë mbështetje materiale paralele shumë të fuqishme. Nuk mund të lejojmë dhe këtë mendoj se Qeveria duhet ta ketë parasysh, që të shkojmë në veprime inercioni, në veprime kur, ta zëmë, Sindikata e Bashkuar apo dikush tjetër inicon pozicionin aktual material të punonjësve të arsimit dhe t'i jepet një injeksion, siç tha kolegu më herët, për të kapërcyer gjendjen.



[/ vijon në faqe 14 /](#)

S'mund të lejojmë, po ashtu, paralelisht dhe s'është në rregull që në paralajmërim për përmirësimin e pozitës del po ashtu paralajmërimi tjetër paralel se është kjo e mundshme për këtë periudhë apo për atë periudhë.

Bajram Kosumi në fillim foli për procesin e përgjithshëm të reformave në arsimin në Kosovë, i cili sipas tij duhet të shoqërohet me debate publike të sferave që merren me këtë çështje. Procesi i reformave është interes i dyanshëm. Aq sa është interes i pushtetit, i Qeverisë dhe i Ministrisë, po aq është edhe interes i qytetarit. Prandaj, ky proces nuk mund të shkojë pa një debatim publik të tij. Duke dhënë disa ide për çështjen e financimit, Kosumi propozoi participim në pagimin e shkollimit të mesëm.



Drita Statovci theksoi se arsimi në Kosovë tanimë është përfshirë nga reformat bashkëkohore, madje në arsimin e ulët, atë të mesëm dhe në atë të lartë. Kjo është një arritur që na bënë të krahueshëm me të tjerët në Evropë. Reforma është një dukuri që lë hapësirë për lëvizje, për ndryshime dhe avancime aty ku shfaqet nevoja. Jo rrallë, përvoja tregon preferencën për përshtatje dhe njohuri të reja. Në çdo shoqëri, në planprogramet mësimore të tyre projektohet njohja e trashëgimisë, njohja e identitetit kulturor përgjithësisht, njohja e kulturës njerëzore.



Sala Ahmetaj, theksoi se midis shkollës dhe shoqërisë së një vendi duhet të sigurohet lidhje e fuqishme dhe kushtëzim i ndërsjellë.



Edi Shukriu shprehu mendimin se Parlamenti aq sa duhet të krijojë dhe avancojë bazën ligjore, ku është bërë një punë e madhe, po aq duhet t' i kushtojë vëmendje dhe ta bëjë kontrollin e implementimit të tyre.



Ramadan Kelmendi tha se hapësira e Universitetit të Prishtinës, duhet të lirohet nga objektet e kultit dhe ato fetare dhe si e tillë ajo të ketë tretmanin që duhet ta ketë si çdokund në botë. Ministria e Arsimit dhe Rektorati i Universitetit, duhet të bëjnë përpjekje më maksimale që Fakultetin Xehetaro Metalurgjik në Mitrovicë ta kthejnë në lokale të veta, aty ku e ka vendin dhe ku duhet ta kryejë misionin e vet.



Shefki Sejdiu kujtoi para të pranishmëve se Diogjeni i famshëm spirituoz porosit: Themeli i shtetit është rinia. Keni kujdes! Dantoni thotë: Pas buke është menjëherë, për një shoqëri, edukata më e nevojshme. E Derek Boku, thotë: Nëse mendoni se arsimi është i shtrenjtë, provojeni paditurinë. Atëherë do të bindeni se arsimi nuk është i shtrenjtë.



Edita Tahiri duke folur rreth strukturave paralele, tha se pasi Ligji është nënshkruar, Ministria ka kompetencë, pra, të merret me këtë çështje dhe natyrisht derisa në një anë duhet të angazhohet të ndërpresë strukturat paralele, në anën tjetër, duhet të gjejë rrugën e



integritit të minoritetit serb në kuadër të Universitetit të Prishtinës.

Melihate Tërmkollli zuri në gojë një deklaratë sipas së cilës shtimi i pagave për arsimtarët prej 10 a 20% qenka një pengesë për 7-8 mijë vende të punës. Kujtoj, tha ajo, është shumë e pamoralshme që arsimtarit tonë, megjithë punën, megjithë sakrificat, t'i bëhet një kushtëzim i këtellë.



Xezair Murati vërejti se edhe më tutje, në një masë, po e varfërojmë teorinë e arsimit, sepse edhe vet jam punëtor arsimi dhe se praktika nuk po i përcjellë në masë të duhur risitë teorike në këtë lëmi. Së këndejmi, krahas vullnetit tonë të mirë, kuadrave përkatëse, nevoiten edhe shumë mjete për pajisjen e sallave, kabineve, mjeteve konkretizuese etj.



Sabile Basha u përqendrua në temën e përkrahjes dhe zhvillimit të institucioneve shkencore, meqë pa një progres të mirëfillt të shkencës, nuk ka as përparim të shtetit e as të shoqërisë në përgjithësi.



Në përfundim të këtyre diskutimeve z. Nexhat Daci theksoi se duhet të nxirret sa më parë ligji mbi shkencën dhe institutet shkencore. Do t' i përkrah të gjitha nismat që Universiteti t' i ketë zgjidhjet e asaj pos nën a) dhe nën b). Kjo duhet të vlejë edhe për arsimin e mesëm, në veçanti atë profesional, një obligim më i madh i komunave, ato që kanë mundësi dhe të mos hezitojnë ta ndihmojnë mësimdhënien dhe mësuesit. Deputetet në vijim aprovuan rekomandimet, pa asnjë votë kundër.



Angazhimet e përbashkëta ndihmojnë kthimin

Kuvendi i Kosovës në seancën e 10 korrikut shqyrtoi çështjen e kthimit të personave të zhvendosur. Kryetari i Kuvendit të Kosovës në fillim informoi deputetët se Kryesia ka pasur mirëkuptim që, me kërkesën e përfaqësuesve të koalicionit “Kthimi” në Kryesi të Parlamentit, të ndërrohet renditja e çështjeve që duhet të debatohen, andaj me konsensus është vendosur si pikë e parë për shqyrtim

Në vijim kryeparlamentari Daci përkujtoi të pranishmit se Parlamenti i Kosovës ishte Parlamenti i parë në rajon, në të cilin janë zhvilluar luftime, që ka sjellë një dokument shumë të rëndësishëm për kthimin e qytetarëve të zhvendosur të Kosovës.

Liderët e partive politike, të TMK dhe të institucioneve të Kosovës, i janë drejtuar me një letër të hapur qytetarëve të zhvendosur, të gjithë ata që Kosovën e konsiderojnë atdhe të vetin dhe e akceptojnë realitetin e krijuar në Kosovë, se janë të mirëseardhur në shtëpitë dhe pronat e tyre dhe t’i bashkëngjiten institucioneve të Kosovës në mënyrë që bashkërisht t’i shpiejnw pwrpara proceset demokratike dhe zhvillimore.

Këto dokumente, të shkruara, të nënshkruara dhe të aprovuara, Raporti që do ta paraqesë zonja Hiks, drej-

toreshë për kthimin në UNMIK dhe debati që do të zhvillohet në Parlament, do të jenë pjesë përbërëse, me të cilat Parlamenti do t’i drejtohet me rekomandime të veçanta opinionit jashtë Kosovës dhe që të gjithë të shpërngulurit të vendosin individualisht të kthehen.

Duke marrë fjalën zonjusha **Pegi Hiks** shprehu kënaqësinë për ftesën bërë për të prezentuar punën e rëndësishme që po bëhet për personat që dëshirojnë të kthehen. Çështja e të kthyerve është një çështje krusiale për të gjithë popullin e Kosovës dhe për të ardhmen e Kosovës. Kosova respekton të drejtat e të gjithëve dhe duhet të mbështesë të drejtat e të gjithë atyre që dëshirojnë të kthehen. Ne duhet të punojmë së bashku që ta bëjmë këtë vend me standarde evropiane. Para një viti, ky Kuvend, ka miratuar një Rezolutë mbi të drejtat e komuniteteve dhe të drejtat

e tyre për kthim. Mendoj se është me rëndësi që unë sot jam këtu për t'ju informuar për progresin që kemi arritur dhe për sfidat që ende i përballim dhe rrugën që na pret.

Shifrat nuk duhet të jenë pikënisja jonë

Ne kemi një sfidë para nesh. Sa njerëz janë të përfshirë në këtë? Unë këtë çështje po e shtroj pasi së pari kam treguar se çështja e shifrave nuk duhet të jetë pikënisja jonë. Mirëpo, m'u për shkak se e di që kjo është një temë me një kundërthënie kontradiktore, me një kundërthënie substanciale, ju e dini se ne kemi një shifër prej më tepër se 200 mijë të zhvendosur. Por ne e dimë që, bazuar në regjistrimin e vitit 99, mund të mos jetë kjo shifër e saktë. Por, unë jam këtu sot që ne

Shembuj shpresëdhënës

Ekzistojnë projekte të kthimeve që po vazhdojnë në gjitha pjesët e Kosovës. Dhe dëshiroj t'ju jap disa shembuj specifik në mënyrë që ju të shihni se aty ku punojmë bashkë arrijmë sukses të mirëfilltë në kthime.

Një shembull është në fshatin Novak të Komunës së Prizrenit. Sot ka 61 familje serbe atje, ndërsa 44 shtëpi po rindërtohen. Kjo për shkak se autoritetet komunale të Prizrenit kanë bashkëpunuar dhe punuar aktivisht me të zhvendosurit.

Para disa javësh, në Biti të Epërm, në komunën e Shtërpçës janë kthyer 56 shqiptarë të Kosovës. Po ashtu ka pasur një kthim në vitin 2002 në Biti të Epërme. Në Magurë janë kthyer 21 hashkalinj dhe diku 25 do të kthehen në këtë vit. Ky projekt ka përkrahur rindërtimin e 12 shtëpive të shqiptarëve dhe do të merrte shumë kohë nëse dëshirojmë t'i përmendim të gjitha projektet që kemi në vazhdim e sipër, por unë vetëm thashë disa shembuj të punës të cilën po e kryejmë.

mos të lejojmë të zhvillohet debati kundër këtyre shifrave dhe të na çorientojnë nga çështja esenciale.

Është një gjë e qartë, se ka me mijëra të zhvendosur dhe shumica prej tyre dëshirojnë të kthehen në shtëpitë e tyre. Ne nuk ka nevojë që të debatojmë rreth shifrave dhe të arrijmë përparim sa i përket kthimit në këtë aspekt.

Në përgjithësi policia po kryen punën e vet

Derisa këto probleme na bllokojnë nganjëherë, në duhet të them se pengesa më e madhe me të cilën ballafaqohemi mbetet siguria dhe liria e lëvizjes. Sidoqoftë edhe në këtë fushë kemi bërë përparim dhe duhet ta dini këtë përparim. Ka shembuj ku është përmirësuar liria e lëvizjes dhe krijohen mundësi për kthim. Ajo që duhet ta bëjmë natyrisht është të sigurohemi se të njëjtat mundësi ekzistojnë anembanw Kosovës. Mirëpo, ka probleme të cilat mbesin sa i përket sigurisë. Ka një trend të vazhdueshëm të dhunës, duke përfshirë edhe krimin ndëretnik, e po ashtu nuk zgjidhen sa duhet këto krime. Në përgjithësi policia po kryen punën e vet mirë dhe i

zbulon dorasit e krimeve. Mirëpo, fatkeqësisht, e njëjta nuk vlen edhe për krimet ndëretnike e kjo është për shkak se të shumtën ata nuk gjejnë bashkëpunim në mesin e komunitetit i cili ndihmon t'i zgjidhë këto krime. Si prindër dhe qytetarë, mund të punojmë në krijimin e një shoqërie të mirëfilltë ku respektohen të drejtat. Me këto përpjekje, premtimet dhe idetë të cilat janë të futura në Letrën e hapur, mund të arrihen dhe Rezoluta të cilën ky Kuvend e kishte miratuar në vitin e kaluar do të vazhdojë të na ndihmojë, theksoi zonjusha Pegi Hicks.

Problemi i kthimit duhet të zbresë nga niveli i manipulimit politik në rrafshin njerëzor e qytetar

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës **Arsim Bajrami** theksoi se institucionet e Kosovës, në praktikën e deritanishme të veprimit, kanë dhënë mjaft dëshmi praktike se janë për kthimin e të gjithë qytetarëve të Kosovës. Qeveria e Kosovës, në disa kontakte dhe veprime, ka dhënë fakte të tilla. Sistemi gjyqësor, po ashtu, ka integruar dhe ka inkuorporuar në përbërjen e vet minoritetet e pakicat dhe të të zhvendosurit. Në përbërjen e Trupave të Mbrojtjes së Kosovës dhe Shërbimit Policor, gjithnjë e më shumë po kemi pjesëtarë të minoriteteve dhe me këtë ne po reflektojmë një politikë pozitive, e cila është një dëshmi para faktorit ndërkombëtar që vërtetë dëshirojmë të ndërtojmë një shoqëri demokratike me vlera qytetëruese.

Një element i rëndësishëm për ta ndihmuar procesin e kthimit, është sigurisht edhe definimi i të drejtave pronësore. Procesi i kthimit do të jetë shumë më i lirë dhe pa ngarkesa, sikur të përshpejtohej zgjidhja e statusit final të Kosovës, theksoi Bajrami.

Sabri Hamiti duke folur në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, përmendi se lidhur me çështjen që po shqyrtohet, ekzistojnë në fuqi dy dokumente institucionale:

Rezoluta mbi të drejtën dhe kushtet e kthimit të të zhvendosurve dhe të refugjatëve, e aprovuar nga Kuvendi i Kosovës, më 7 qershor 2002; dhe

Letra publike, qytetarëve të Kosovës të zhvendosur, e nënshkruar nga udhëheqësit e institucioneve të Kosovës dhe liderët e partive politike, e fillimit të korrikut të vitit 2003.

2. Në të dyja herat, rreth dy dokumenteve të përmendura, ka ndodhur abstenimi i përfaqësuesve të minoritetit serb në Kuvendin e Kosovës;
3. Konsiderojmë se në Kosovë, mund të krijohet një shoqëri demokratike që do të ofrojë të drejtat dhe shansat e barabarta për të gjithë qytetarët e vet;

4. Kosova, si shoqër e barazisë, e jo shoqëri e diskriminimit, qoftë ai pozitiv apo negativ – e ka shansën e përparimit dhe të stabilitetit;
5. Shoqëria stabile krijohet duke ndërtuar raporte në mes të shumicës dhe të pakicës.
Shumica do të shpërthejë, në rast se merremi vetëm me pakicën. Në anën tjetër, pakica do të diskriminohej duke u marrë vetëm me shumicën. Pra, kërkohet një shoqëri e barazisë dhe demokratike, pa asfarë shtrese të elitizuar në emër të çfarëdo kriteri të veçantë.
6. Kthimi vullnetarë e individë që dëshirojnë të jetojnë në shtëpinë e vet dhe me punën e vet, është procesi më normal për zhvillimin e jetës së qetë në Kosovën e pas konflikteve.
7. Kthimi mund të bëhet pa fushata, sepse fushatat, qofshin ato politike apo tjetërfare, nuk zgjidhin probleme, por krijojnë probleme.
8. Problemi i kthimit duhet të zbresë nga niveli i manipulimit politik në rrafshin njerëzor e qytetar, pa pasur parasysh etnicitetin e të kthyerve apo të të zhvendosurve;
9. Të kthehet secili në shtëpinë e vet dhe të jetojë me punën e vet, jo për ta bërë Kosovën multietnike, që është një slogani i pastër politik, por për të ushtruar të drejtën njerëzore që është një program krejt human.
10. Në një shoqëri të paskonfliktit, në një shoqëri pas provës së gjenocidit mbi shqiptarët, siç është Kosova, nuk ka mundësi të krijohen kushte të veçanta për të kthyerit;
11. Në vajtjet dhe ardhjet në Kosovë, si në të kaluarën, edhe tash, ka tendencë të manipulimit me numrin e njerëzve të zhvendosur.

Dragisha Kërstoviq, tha se grupi i deputetëve të koalicionit „Kthimi”, po bënë përpjekje të mëdha për realizimin e rezultateve më të mira për kthim, dhe mu për këtë shkak grupi i deputetëve të koalicionit „Kthimi” me aktivitetet dhe veprimet e veta ia arriti të zë vendin e koordinatorit ndërmintor në Qeverinë e Kosovës, si dhe vendin e këshilltarit për të kthyerit pranë Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, çka do të thotë se kthimi me të vërtetë është çështje me rëndësi dhe mu për këtë edhe i kemi fituar këto dy resore mjaftë të rëndësishme në Qeveri dhe në misionin ndërkombëtar.

Përveç kësaj, koalicioni „Kthimi” mban mbledhje të rregullta me Zyrën për kthim dhe të bashkësive. Unë me këtë rast dua ta falënderoj zonjën Pegi Hicks-drejtoreshë

KUVENDI I KOSOVËS

Në mbështetje të kreut 9.1.26 të Kornizës Kushtetuese, në seancën plenare të mbajtur me 10 korrik 2003, shqyrtoi çështjen e kthimit të personave të zhvendosur, dhe pas debatit të gjërë dhe harmonizimit të qëndrimeve të të gjitha grupeve parlamentare, miratoi këto :

REKOMANDIME

1. Kuvendi rikonfirmon mbështetjen e tij për Rezolutën për të drejtat dhe kushtet e kthimit të të zhvendosurve dhe të refugjatëve të datës 7. qershor 2002 dhe e njezh mesazhin e udhëheqësve të institucioneve të Kosovës lidhur me kthimin e të zhvendosurve.
2. Kuvendi konsideron se kthimi i të zhvendosurve paraqet një çështje humane dhe respektim të lirive dhe të të drejtave të njeriut dhe kërkon që ky proces të mbrohet nga implikimet dhe keqpërdorimet politike.
3. Kuvendi rikonfirmon përcaktimin që Kosova të ndërtohet si shoqëri demokratike që ofron kushte për barazi të plotë të të gjithë qytetarëve të saj pa dallime dhe privilegje.
4. Kuvendi angazhohet që procesi i kthimit të të zhvendosurve të jetë në baza vullnetare në pronat dhe shtëpitë e tyre.
5. Kuvendi konsideron se integrimi i të gjithë qytetarëve në kuadrin e të gjitha institucioneve dhe strukturave të shoqërisë së Kosovës do të ndihmojë procesin e kthimit të të zhvendosurve.
6. Kuvendi angazhohet për krijimin e një klime tolerante të mirëbesimit e të sigurisë për të ndihmuar procesin e kthimit dhe fton të gjithë qytetarët e Kosovës që të ndihmojnë këtë proces.
7. Kuvendi konsideron se mbështetja financiare ndërkombëtare për rregullimin e infrastrukturës së nevojshme, zhvillimin ekonomik, hapjen e vendeve të reja të punës, paraqet një hap të rëndësishëm në procesin e kthimit të të zhvendosurve.
8. Kuvendi i Kosovës kërkon që kthimi i të zhvendosurve të mos kufizohet në baza etnike por të përfshijë të gjithë qytetarët e Kosovës të zhvendosur gjatë dhe pas luftës brenda dhe jashtë territorit të Kosovës.
9. Kuvendi i Kosovës do të përcjellë zbatimin e këtyre rekomandimeve dhe kërkon nga institucionet e Kosovës të të gjitha niveleve që të punojnë për realizimin e këtyre rekomandimeve.

Prishtinë, më 10 korrik 2003.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

Dërgohet :
Zyrës së PSSP-së,
-Presidencës,
-Qeverisë dhe
-Të gjitha komunave

Akademik Nexhat Daci

e kësaj Zyreje për kontaktet e deritashme, për pjesëmarrjen e saj në punën e sotme të këtij Kuvendi dhe diskutimin për këtë çështje.

Bajram Kosumi tha se pengesa më e madhe për procesin e kthimit të të zhvendosurve në shtëpitë e tyre dhe në pronat e tyre - është pikërisht politizimi i kësaj çështjeje. Nëse kthimi i personave të zhvendosur nga Serbia lidhet me “kthimin e Serbisë” nuk do të ketë kurrë kthim, ky është politizim dhe këtë e bëjnë politikantët e Beogradit, jo me qëllim të kthimit të të zhvendosurve, por ata bëjnë lojëra politike në kurriz të të zhvendosurve, në kurriz të serbëve të zhvendosur.

/ vijon në faqe 18 /

Faik Marolli pohoi se kthimi i të zhvendosurve është një kthesë dhe hap pozitiv për të gjithë ne, në rrugë drejt Evropës me elemente perëndimore. Hashkalinjtë janë numri i dytë, pas romëve të zhvendosur në Serbi, Maqedoni e Mal të Zi. Në Kosovë është shtëpia – trualli i tyre. Pra, është koha që të kthehen në shtëpinë, në truallin e tyre dhe të gjithë ne, së bashku, ta ndërtojmë një Kosovë të re, demokratike, multietnike ku qytetarët do të trajtohen njësoj e të barabartë para ligjit.

Kolë Berisha në vijim iu drejtua z. Kërstoviq, me fjalët se ju nuk keni informata të duhura. Në Klinë ka kthim, ka pasur dhe ka dhe t'ju njoftoj edhe për këtë se delegati i Asamblesë Komunale në Klinë nga përkatësia serbe, tash gjashtë muaj nuk merr pjesë fare në asamble, edhe pse e ka të sigurt transportin prej vendbanimit deri në komunë, do të thotë në Klinë. Domethënë nuk është fajtor Komuna e Klinës. Dhe këto kthime janë në Klinë dhe pikërisht aty ku kryetari i komunës ka të humbur djalin, ka një vëlla të humbur, ka dy nipa, domethënë djemw të motrës dhe ka tre dajë të zhdukur. Përkundër kësaj, kryetari i komunës, bashkë me Asamblenë Komunale janë angazhuar për kthimin e këtyre të zhvendosurve, të cilët kanë dashur dhe mund të kthehen. Prandaj, nuk është e vërtetë ajo se s'ka kthim në Klinë.

Smajl Latifaj theksoi se Serbia ka bërë shumë hapa politik të fshehtë e të hapur edhe duke përdorur pjesëtarët e popullit serb për të përfituar në kurriz të Kosovës. Shumë nga të zhvendosurit e sotëm janë akoma vegla në duart e appetiteve pushtuese të pushtetarëve serbë. Kosova as sot, pas luftës që ka bërë, nuk është e liruar nga grackat e mëdha politike të Serbisë.

Hasan Meta shtroi pyetjen: sa bashkësia ndërkombëtare ka faj në politizimin e kësaj çështjeje, duke vlerësuar se ajo ka faje në këtë vështrim, për arsye se manipulohet, me qëllim apo pa qëllim nga politika serbe, e cila është hegjemoniste dhe ende kolonialiste.

Mahmut Bakalli kujtoi deputetët se roli ynë, si Parlament, nuk është vetëm të mbështesim dhe të konfirmojmë, por roli ynë sot është që të bëjmë edhe një hap më përpara dhe të jemi nxitës të procesit të kthimit të të zhvendosurve kosovarë.

Unë mendoj se ne duhet të shpejtojmë në mënyrë humane dhe demokratike procesin e kthimit të të zhvendosurve. Në rast se nuk e bëjmë këtë, atëherë çështja do të politizohet dhe atëherë do të marrë dimensione të kolonizimit të Kosovës. Prandaj, dialogjet rreth politizimeve dhe kolonizimit, nuk do të kishin kurrfarë kuptimi po qe se ne angazhohemi

vërtetë dhe sinqerisht, edhe ne, edhe UNMIK-u, për kthimin individual, sipas vullnetit të të gjithë të zhvendosurve nga Kosova, në këtë rast, posaçërisht të serbëve të zhvendosur.

Dritan Lajçi tha se është problematike çështja e vrasjeve dhe e plagosjeve në Kosovë. Edhe unë e kam shtruar shpesh një pyetje: Pse ato ndodhin vetëm në momentin kur vijnë delegacione të huaja, siç është Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara; siç janë liderët botërorë. Nuk e di kush është vrasësi, kush është fajtori, mirëpo e di se kah shkojnë efektet politike. Është me vend ai deklarimi i gjeneralit të NATO-s kur tha se liderët botërorë të mos paralajmërojnë datën e vizitës, për shkak se efektet politike po shkojnë dikah tjetër. Ne e dimë në këtë rast kush është fituesi dhe kush është humbësi.

Svetomir Samarxhiq tha se unë dua t'iu siguroj se të gjithë ne, pra të gjithë, jemi viktimë të pafajshme të një lufte dhe se pikërisht prej kësaj është dashur të mësojmë, por siç duket këtë nuk ia kemi arritur. Ne megjithatë e kemi një tipar themelor, mos më keqkuptoni, mendoj për të gjithë ne, tipar që ka të bëjë me arrogancën, inatin dhe jotolerancën. Ky është rast i volitshëm të themi se ku jemi tani, se me të vërtetë ne si përfaqësues të zgjedhur të popullit kosovar a e shprehim dëshirën dhe vullnetin e këtij populli, apo edhe mëtej sekëlldisemi të themi diçka në kuptimin që ekstremistët tanë mendojnë.

Mendoj se nga kjo duhet të lirohemi, në mënyrë që të angazhohemi për atë se cili është interesi ynë.

Xhevdet Neziraj shprehu mendimin se personat të cilët janë kthyer nga radhët e komunitetit egjiptas, ballafaqohen me shumë probleme. Ata janë që 3-4 vite dhe ende nuk iu është ndërtuar asgjë, ende nuk është ndërmarrë asgjë në ndërtimin e infrastrukturës, ende nuk është bërë ndonjë shkallë më e lartë e punësisë, ende nuk është bërë asnjë hap i bashkësisë ndërkombëtare që të bëjnë integrimin e tyre, ndërsa shpeshherë dalim me shifra se është tejkaluar përqindja në Shërbimin Policor të Kosovës nga komunitetet joserbe dhe joshqiptare. Ndërsa, vetëm në Komunën e Gjakovës nga mbi 6 mijë pjesëtarë të komunitetit egjiptas nuk është asnjë pjesëtar i policisë.

Oliver Ivanoviq theksoi se kthimi do të duhej të ishte përparësi e të gjithë atyre që ushtrojnë detyra me përgjegjësi. Fotografia për atë se si duket situata në Kosovë kundruall botës, është njaftë e rëndësishme për vet faktin se çfarë do të mendojë ajo botë për ne, kështu që kur ta formojë bindjen për ne, në bazë të sajë edhe do të veprojë. Se a do të mbetemi ne si vrimë e zezë në Ballkan apo jo, kjo pikësepari varet prej nesh. Nuk ekzistojnë marifetët me të cilat do ta lëmë pasdore procesin e kthimit. Nuk ekziston tregimi për politizimin e kthimit sepse politizimi i kthimit është tregimi për politizimin. Secili ka të drejtë për

kthim. Çdo kushtëzim, vënie kushtëzimesh në kuptimin se ai nuk mund të kthehet, kështu që mu për këtë do ta citoj një maksimum shpesh të përdorur se: «Nuk mund të kthehet ai që i ka përgjakur duart», ose «Nuk mund të kthehet ai i cili është pjesëtar i regjimit», ose «Nuk mund të kthehet ai që ka qenë në polici apo në ushtri». Ne si civil apo politikan këtë nuk duhet kështu ta kuptojmë.

Hydajet Hyseni theksoi se ne kemi mbështetur kërkesën e grupit “Kthimi” për të diskutuar çështjen e kthimit, por unë dua të jam i sinqert, nuk e kam pasur krejt të qartë për çfarë kthimi po bëhet fjalë. Fjala kthimi, gjithmonë ka shkaktuar keqkuptime. Nëse është fjala për kthim të qytetarëve, siç foli kolegu para meje, unë jam i bindur që jo vetëm kjo përbërje, por në përgjithësi shumica dërrmuese e Kosovës do të ishin gjithmonë për, në dakord. Por nëse bëhet fjalë për një kthim prapa, për kthim në të kaluarën, për kthim në “Kosovë e Metohi” ta them figurativisht, jo zotëri – s’do të ketë mirëkuptim.

Nuk mund të sigurohet kthimi i qytetarëve nëse fryhen shifrat. Nëse aty futen policët e ardhur nga Serbia, ushtarët e ardhur nga Serbia dhe në këtë mënyrë dyfishohet numri i të zhvendosurve nga Kosova, ose e të shpërngulurve nga Kosova. Qytetarët e Kosovës, – po, janë të mirëseardhur, por në Kosovën e re.

Akademik Mark Krasniqi theksoi se në këtë situatë, është shumë vështirë që ta krijojmë një jetesë demokratike dhe fqinjësore. Megjithatë, ne do të

bëjmë përpjekje patjetër dhe këto përpjekje mjerisht po kërkohen vetëm prej palës shqiptare.

Gojko Saviq theksoi se pohimet kinse gjendja në Kosovë është e ngjajshme si në shtetet tjera të Evropës, informatë kjo prej dje mjaftë e freskët, ka për qëllimdy gjëra: Që Kosova të vendoset në pozitën e shteteve dhe të gjithë ata të cilët këtë mashtrim, gjegjësisht të gjithë ata që këtë mashtrim të imponuar si të shenjtë nuk e besojnë, dhe këtë e thonë pikërisht ata që i japin llogari të parit tanimë ish Përfaqësuesit të Sekretarit të përgjithshëm.


Zylfi Merxha tha se është për lavdatë referati i zojës Pegi Hicks, por më ka habitur që s’ka marrë tri sende: romët e mi që janë në Mitrovicë, edhe ata janë refugjatë e të kthehen në Kosovë; ose që s’e ka marrë Plemetin, ku janë 700 vetë në llogor; ose 1.000 vetë, të cilët që gjashtë javë ditë janë në kufi të Greqisë.

Flora Brovina shprehu mendimin se mosdefinimi i statusit final të Kosovës është një faktor kryesor i këtij problemi. Sa më shpejt të zgjidhet çështja e statusit, aq më shpejt do të zgjidhet edhe dilema për ata serbë që duhet të integrohen dhe jetojnë në Kosovë. Në të kundërtën, manipulimi me ta do të vazhdojë.

E di se ka serbë që thonë se asesi nuk do të jetojnë në Kosovë të pavarur. Atëherë, le të ndalemi dhe të mendojmë e të pyesim: a janë shqiptarët që nuk duan të jetojnë me serbët apo është e kundërta.

TË PAMUNDËSOHET KRIMI NDAJ FËMIJËVE

Drejtori i shqatës “Fëmijët kosovarë dhe evropianë për të drejtat e tyre” që vepron në Prizren, Mitat Bytyqi, në takim me kryetarin i Kuvendit të Kosovës, Nexhat Dacin, ka shfaqur shqetësimet për pozitën e fëmijëve dhe të rinjve të Kosovës dhe për respektimin i pamjaftueshëm të të drejtave të tyre. Zoti Bytyqi i ka shpjeguar gjerësisht kryeparlamentarit Daci pozitën e rëndë të fëmijëve nëpër qytetet dhe fshatrat e Kosovës dhe ankesat e tyre për mundësitë e vogla të realizimit të fëmijëve, si dhe për shkeljen e shpeshtë të të drejtave të tyre elementare. Profesor Daci është pajtuar se fëmijët dhe të rinjtë tanë janë ardhmëria e vendit dhe se meritojnë përkujdesje më të mirë institucionale. Ai në këtë vështrim e ka quajtur të domosdoshëm miratimin e ligjeve që garantojnë mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të fëmijëve dhe të rinjve dhe ka premtuar edhe angazhimin personal të tij që kjo të realizohet sa më parë. Kryeparlamentari Daci ka vënë në spikamë se duhet evitohet dhuna ndaj fëmijëve dhe të rinjve dhe të mos përsëriten krimet e rënda ndaj tyre si në Pejë dhe Gorazhdëc.



Privatizimi në funksion të zhvillimit të ekonomisë së tregut

Ekzistojnë 480 ndërmarrje shoqërore, përkatësisht NSH të regjistruara, mirëpo prej tyre vetëm rreth 100 deri 130 vepronë si koncerne, si ndërmarrje që vërtetë vepronë për atë që janë krijuar dhe paguajnë tatimet

Shqyrtimi i procesit të privatizimit ishte temë thelbësore e mbledhjes së 3 korrikut të Kuvendit të Kosovës. Në emër të Agjencionit dhe Shtyllës së Katërt folën **Jurgen Fos** dhe **Ahmet Shala**. Në fillim z. Fos foli për rëndësinë e privatizimit për Kosovën. » Atë që kërkojmë ne, nuk është që të bëjmë para të gatshme për buxhetin e konsoliduar të Kosovës përmes shitjes së ndërmarrjeve. Të hyrat nga ndërmarrjet janë të dorës së dytë, domethënë me rëndësi është nxitja e privatizimit për të arritur zhvillimin ekonomik dhe sektorin privat në Kosovë. Kjo është plotësisht e qartë nga situata ekonomike që ekziston në Kosovë aktualisht. Sot, Kosova ende është si një shoqëri harxhuese, e lidhur nga zemërgjerësia e donatorëve ndërkombëtarë dhe nga diaspora kosovare. Rreth 70 – 80% e çdo shfrytëzimi në Kosovë, ose e çdo malli në

Kosovë është i importuar. Thuajse asgjë nuk eksportohet, ndërsa deficioni i tregtisë është aq i lartë sa edhe prodhimet vendore».

Kjo është një situatë e paqëndrueshme, tha në vijim Fos. Ndërmarrjet shoqërore janë themeli i industrisë së Kosovës. Megjithatë, me disa përjashtime, ato janë në një gjendje shumë të mjerueshme aktualisht. Ekzistojnë 480 ndërmarrje shoqërore dhe ne i quajmë ato NSH të regjistruara, mirëpo prej tyre vetëm rreth 100 deri 130 vepronë si koncerne, si ndërmarrje që vërtetë bëjnë biznesin për çka janë krijuar dhe paguajnë tatimet.

Vepruhet në një "zonë të errët"

Pjesa më e madhe e këtyre ndërmarrjeve shoqërore është diku në një zonë të errët duke shfrytëzuar pasuritë

Tashmë ka lindur fëmija i quajtur privatizim

Privatizimi në të gjitha vendet në tranzicion është procesi më i vështirë, sepse nënkupton ndryshimin e mentalitetit, mënyrën e të menduarit drejt një progresi, drejt një ekonomie të tregut. Vendet në tranzicion, duke përfshirë edhe Kosovën, nuk kanë mundur të zgjidhin problemin e papunësisë, që është tejte e lartë në Kosovë. Këto ishin disa nga konstatimet në takimin e kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Nexhat Daci me delegacionin e AKM-së, të përbërë nga Ahmet Shala, zëvendës drejtor dhe Johan Johanson, kryesues i procesit të privatizimit në AKM. Profesor Daci tha se për më shumë se dy vjet është konsumuar shumë mund, energji dhe dije në relacionin Prishtinë- Nju - Jork, si dhe në zyrat e vendosjes, në Uashington, Londër etj. Fillimi i privatizimit është një ndodhi shumë e mirë për Kosovën, që ngjan me një fëmijë të sapolindur. Po gëzohe mi që ka lindur fëmija i quajtur privatizim, edhe pse nuk ishte një lindje normale, por prerje cezarike, por kryesore është që fëmija ka lindur, ndërsa ne do të bëjmë çmos që atë fëmijë ta ushqejmë dhe ta edukojmë mire, në dobi të Kosovës. Ekzistojnë shpresa te investitorët e ardhshëm, por apelohe tek investitorët vendas që t'i bashkojnë mjetet, ta mënjanojnë atë mentalitetin e vjetër që vetëm një njeri ta ketë tërë kapitalin nën jastëk, sepse në ekonominë e tregut nuk mund të depërtohet më në këtë mënyrë. Parat është e nevojshme t' i bashkojë edhe diaspora jonë, le t' i blejnë objektet me çmime të ekonomsë së tregut. Punëtorët le ta dinë se insti-

tucionet e Kosovës, duke përfshirë edhe agjencionin, janë shumë të interesuar që nga ato mjete dhe nga puna e suksesshme e qeverisë të rritet buxheti i Kosovës, të krijohen programe sociale, të krijohen programe të rikualifikimit të atyre që janë në moshën e caktuar. Prandaj, Parlamenti dhe institucionet tjera të Kosovës do ta mbrojnë Kosovën në të gjitha aspektet, në aspektin politik, ekonomik dhe të sigurisë. Është gabim i madh për ata që mendojnë se AKM-ja është kundër interesave të ekonomisë së Kosovës. Në rajon dhe në fqinjësi ka shumë forca që duan ta pengojnë këtë proces privatizimi, do të jepnin shumë mjete të mos ketë sukses. Ne nuk duhet të jemi nostalgjik për një sistem që e ka udhëhequr klasa punëtore, sepse i dimë rezultatet. Nëse Agjencioni beson se edhe Ferronikeli do të riaktivizohet dhe gradualisht edhe sgmente të caktuara të kompanive që janë shkatërruar plotësisht është një shenjë e mirë lshim një qind për qind të këtij mendimi. Në vijim kryeparlamentari Daci theksoi se është biseduar edhe për domosdoshmërinë e një kujdesi më të madh ndaj punëtorëve dhe nevojave të tyre. Atje ku të gjitha mundësitë ligjore dhe të ekonomisë së tregut lejojnë ne do të jemi bashkarisht me secilin qytetar të Kosovës, mos të mendojë askush se Kosovës i duhet edhe një datë shtatori për grevë të përgjithshme që do ta paralizonte Kosovën, ta kthente në të kaluarën. Do të bisedoj edhe me sindikalistët, tha Daci, por kthim prapa në një Kosovë të vjetër dhe në një sistem të vjetër nuk ka dhe ne nuk do të punojmë për atë. E mira e Kosovës është që procesi i privatizimit të vazhdojë, duke mënjauar edhe sëmundjet e fëmijërisë. Mund t' ju them se nuk kemi pasur asnjë ndryshim në koncept për ardhmërinë e Kosovës dhe zhvillimin e saj. Kuvendi kishte të drejtë, sepse ai gabimisht në fillim u shkyq nga ky process.

shoqërore për përfitimin e disa menaxherëve dhe disa punëtorëve të privilegjuar, pa paguar tatimet.

Kjo situatë, jo vetëm që na bën harxhime të rëndësishme të Kosovës, por gjithashtu dekurajon investimet e reja në Kosovë, sepse nuk i lë hapësirë konkurrencës. Asnjë biznesmen i ndershëm nuk mund të konkurrojë në tregun e zi. Për këtë arsye, privatizimi është thelbësor për Kosovën, në mënyrë që Kosova të ndërtojë një ekonomi të tregut funksional. Dhe, për këtë arsye, privatizimi është shumë më tepër se sa vetëm transferimi i titullarit të pronësisë nga një kolektiv i punëtorëve të sipërmarrësi privat. Domethënë, është një proces që ndërmarrjet e Kosovës i shpie në një ekonomi të tregut të gjerë.

Cilat janë përfitimet nga procesi i privatizimit? Nga programi i privatizimit në Kosovë, ne do të kemi prodhime të reja, do të kemi vende të reja të punës, do të kemi taksat më të mëdha dhe do të kemi arkëtim më të madh të taksave dhe kontribute më të mëdha. Por, fatkeqësisht, këto përfitime do të realizohen në një afat më të gjatë kohor e jo menjëherë, derisa shpenzimet e këtij programi janë imediate. Gjithashtu, përfitimet do të shkojnë në dobi të Kosovës dhe ekonomisë së Kosovës, në aspektin më të gjerë, derisa shpenzimet janë të mëdha, duke pasur parasysh situatën aktuale, duke përfshirë edhe disa menaxherë në VM dhe gjithashtu duke pasur parasysh tregun e zi. Për këtë arsye, privatizimi, programi i privatizimit të cilin ne tani po e prezentojmë, ndoshta nuk do të jetë një punë e lehtë. Do të jetë vërtet një luftë e vështirë, por një luftë e nevojshme për Kosovën, në mënyrë që këtu të ndërtohen themelet e ekonomisë. Me

këtë do të ndërtohet edhe e ardhmja.

M'u për shkak të arsyeve që përmenda, programi i privatizimit është i mbështetur nga Qeveria e Kosovës dhe unë shpresoj se është i mbështetur në veçanti nga ju, përfaqësuesit e popullit të Kosovës dhe gjithashtu mbështetet në mënyrë unanime nga komuniteti ndërkombëtar, domethënë nga Kombet e Bashkuara, nga Bashkimi Evropian, nga Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, nga Shtetet e Bashkuara, nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe nga të tjerët, pra, kemi një mbështetje të madhe për këtë Program.

Në vijim ai foli për kornizën ligjore, e cila tashmë është e gatshme. Kjo kornizë përfshin ligjet themelore, rregulloren, përmes së cilës është themeluar Agjensioni Kosovar i Mirëbesimit, në qershor të vitit 2002 dhe me këtë kemi edhe rregulloren tjetër e cila themelon odën, ose dhomën e posaçme në Gjykatën Supreme të Kosovës, në qershor të vitit 2002. Gjithashtu, është e ashtuquajtura rregullore për shfrytëzimin e tokës, e cila posa është nxjerrë në formë të ligjit në maj të vitit 2003. Kjo rregullore, ka rëndësi të posaçme, m'u për shkak se bën konvertimin e të drejtave të shfrytëzimit të tokës që mbahen nga ndërmarrjet në pronësinë shoqërore dhe që për momentin nuk mund të transferohen dhe nuk mund të shfrytëzohen, që të sigurohen kredi. Ndërkaq, struktura administrative është çelësi i këtij sistemi, apo në qendër të këtij sistemi kemi Agjensinë Kosovare të Mirëbesimit. AKM është një kombinim i AP dhe fondit shtetëror, të pronës, domethënë bart përgjegjësinë e bartjes së privatizimit të të gjitha ndërmarrjeve në pronësi



shoqërore në Kosovë dhe e dyta, administrimin dhe ristrukturimin e të gjitha ndërmarrjeve në pronësi publike në Kosovë.

Procesi i privatizimit pa perfshirjen e Qeverisë së Kosovës

Ahmet Shala theksoi se Kosova deri më sot, nuk ka arritur të krijojë një imixh pozitiv, një vend atraktiv për të investuar. Imixhi përmirësohet jo vetëm me ligje të mira, por edhe me implementimin e tyre të përsosur. Është një moment, faktikisht historik, për Kosovën që gjatë procesit të privatizimit, edhe modeli më i mirë nuk do të ketë sukses, në qoftë se ky Parlament nuk sjell ligje dhe nuk bën disa ndryshime të politikës doganore, tatimore dhe fiskale. Besoj se ministritë përkatëse do të vijnë shpejt me propozimet, ndërsa komuniteti ndërkombëtar dhe të gjithë ata që dëshirojnë që në Kosovë të ketë investime, do t'i përkrahin ato.

Hydajet Hyseni, si anëtar i Kryesisë dhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK tha se procesi i privatizimit, që me të drejtë, vlerësohet i një rëndësie vitale për Kosovën e re dhe të ardhmen e saj, po zhvillohet, pothuaj, pa përfshirjen e Qeverisë së Kosovës. Një nga synimet e privatizimit, siç është thënë sa e sa herë, është mundësimi i shfrytëzimit të resurseve dhe potencialeve të brendshme kosovare. Nëse mënjanohet Qeveria dhe ministratë e saj, ose nëse iu imponohet atyre një rol marginal, e krejt formal, mund të merret me mend sa e si angazhohen resurset dhe potencialet tjera kosovare. Edhe në dokumentin e mirënjohur – “Standardet para statusit”, çështja e privatizimit zë një vend shumë të rëndësishëm dhe është në fakt njëri ndër standardet e kërkuara, për të cilat po fajësohet Kosova. Por, subjekteve të brendshme, u është lënë si detyrë, vetëm të citoj “përkrahja për krijimin e një kornize solide ekonomike dhe përkrahja publike aktive për privatizimin nga ana e bartësve të funksioneve publike”. Kaq, vetëm - “përkrahja”!?

Tani, edhe në paraqitjen që dëgjuam këtu, ju patë: prej Qeverisë nuk kërkohet asgjë, si Qeveri. Po, prej Kuvendit, kërkohet diçka më shumë: ndihmë, promovim, të përmenden ndonjë çështje, të merret pjesë në një aktivitet dhe kaq.

Qeveria, në bashkëpunim me praninë ndërkombëtare, duhet të hartojë një strategji unike gjithpërfshirëse për rimëkëmbjen dhe transformimin e ekonomisë së rrënuar kosovare dhe angazhimin pa pengesa e ngatërtime absurde politike, administrative, të potencialeve krijuese, kooperuese, afariste e financiare të njerëzve tanë si brenda Kosovës, ashtu edhe jashtë saj.

Ekonomia, edhe ashtu e rrënuar e Kosovës, po ngulfatet e rrënohet edhe më tej. Ekziston një bindje shumë e përhapur, jo edhe pa bazë, se në shumë raste, rrënimi

është i qëllimshëm: – ulja e çmimit. “Mbytet pula për t’ia marrë vezët”!

Naim Maloku tha se UNMIK-u e ka mandatin, sipas Rezolutës 1244 për të administruar dhe menaxhuar drejt dhe mirë me pronën shoqërore në Kosovë, por nuk ka mandatin t’ia ndërrojë titullarin asaj prone. E ka mandatin të menaxhojë dhe administrojë ndërmarrjet derisa institucionet e Kosovës nuk krijohen dhe ato pastaj t’i marrin kompetencat dhe të kryejnë procesin e privatizimit.

A është bërë menaxhimi dhe administrimi i drejtë i ndërmarrjeve publike në katër vitet e fundit? Them, se jo! Menaxhimin dhe administrimin e ndërmarrjeve publike e ka karakterizuar jotransparenca e plotë. Po e marr, ta zëmë, një shembull konkret. 1600 euro paguhet një këshilltar në Posttelekomin e Kosovës. Dhe, - është verifikuar, me konkurs, që Kosova nuk ka kuadër të tillë që i plotëson të gjitha normat e vendit të punës së këshilltarit në PTK që merr 1600 euro në ditë.

Qëndrimi i Grupit Parlamentar të Aleancës është që AKM duhet të hyjë në kompetencat e Qeverisë së Kosovës dhe së bashku me të, pra, do të ishte kompetent ky Parlament për t’ua caktuar juve rolin e jo ju t’na bëni këtu media të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit.

Duke folur në emër të Grupit Parlamentar të LDK, dhe si anëtar i Kryesisë, zoti **Fatmir Sejdiu** shtroi çështjen sa Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, si faktor i rëndësishëm dhe i nevojshëm për Kosovën, e sheh procesin e punës në bartjen e përgjegjësi në institucionet e Kosovës apo si institucion i Kosovës. Me këtë, e them konkretisht: nëse Kuvendi i Kosovës, veprimtari themelore të tij ka miratimin e ligjeve, ne do të kemi kohën, do të kemi fazat në të cilat do të ndeshemi domosdo me materie të cilat janë edhe materie preokupimi apo obligimi i drejtpërdrejt në Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit.

Lubomir Stanojković tha se si e mëtej e parë e privatizimit në Kosovë konsideroj jotransparencën e saj. Këtë e theksuan edhe disa nga parafolësit e mi. Dmth. Mungesa e informatave të mjaftueshme... Nëse ky është fillimi, atëherë seriozisht e përshendes.

Pastaj, kushtet e sigurisë që janë të gjitha, por nuk janë të sigurta, do të ndikojnë që investitorët e jashtëm të vijnë (të investojnë) në Kosovë. Në mënyrë të veçantë, problemi i parë dhe i dytë do të ndikojnë në mosinteresimin e biznesmenëve me prejardhje nga Kosova që, momentalisht janë ndër të parët në Beograd, krahas Kariçëve dhe Ljube Mihajloviçit dhe supozoj se i njihni.

E meta e tretë, gjithashtu e madhe, sipas mendimit tim, është mungesa e programit social. Mungesa e këtij programi do të ndikojë që punëtorët gjithnjë e më tepër të jenë të pakënaqur dhe se në këtë kontekst edhe do ta kundërshtojnë privatizimin.

Shtrenjtimit janë bërë nga vetë organet përkatëse komunale

Në mbledhjen e 26 qershorit të Kuvendit të Kosovës, ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Ali Jakupi u përgjigj në disa pyetje të deputetit Ismajl Kurteshi lidhur me shtrenjtimin e bukës dhe të ujit në komunën e Gjilanit, si dhe në pyetjen se çka ka ndodhur dhe ç' është ndërmarrë në ndërmarrjen «Eximkos» dhe «Gragjevinar». Ministri Ali Jakupi theksoi se posa kemi marrë pyetjen me shkrim, janë angazhuar organet përkatëse të Ministrisë, kanë bërë hulumtimet dhe kanë ardhur në konstatimin se shtimi në 30 cent i bukës 500 gramëshe, pothuaj është e njëjtë si çdokund, ndërkaq, shtimi i çmimit të ujit është bërë në Gjilan 100%, do të thotë prej 15 cent në 30 cent për një metër kub. Përgjigjja jonë është se të gjitha këto shtrenjtime janë bërë nga vetë organet komunale, sepse mbështetjen e kanë në Rregulloren 2000/45, përkatësisht në kapitullin 1, neni 3, alineja f) dhe l) të kësaj Rregulloreje që përcakton kompetencat vetëqeverisëse të komunave. Do të thotë, përkundër faktit se Ministria ka shërbimet dhe zyret për mbrojtjen e konsumatorëve, të gjitha këto çështje janë në kompetencë të komunave. Përgjigjja jonë është e tillë dhe se bordi, i cili ka ngritur çmimin e ujit, është i emëruar nga AKM-ja, do të thotë nga Agjensioni i Mirëbesimit Kosovar.

Me datën 12.6.2003, në bordin e Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit është shqyrtuar situata në «Eximkos» lidhur

me shitjen e asetëve në Beograd e gjetiu. Po ashtu është shqyrtuar edhe çështja e «Gragjevinarit», një ndërmarrje në Shtërpcë, e cila është privatizuar dhe është blerë nga drejtori i asaj ndërmarrjeje. Janë ndërmarrë masa, në atë mbledhje kam qenë edhe unë prezent, dhe aty janë aplikuar masat e drejtpërdrejta, që do të thotë se për fajësinë tjetër, është duke punuar Zyra Ligjore e AKM – së dhe varësisht nga gradacioni, niveli i keqpërdorimeve deri në kriminalitet do të ndërmirren masa të mëtutjeshme.

Të gjenden zgjidhje të qëndrueshme për të gjitha qendrat rinore në Kosovë

Ministri i Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Çështjeve Jorezidente, Behxhet Brajšori, në pyetjen e deputetit Alush Gashi për atë se çka ka bërë Ministria për të mundësuar vazhdimin e aktivitetit të Qendrës së Rinisë, meqë ka pasur kërcënime që të mbyllet ajo, tha se pas definimit të përgjegjësive në mes të Qendrës Rinore, Pallatit të Rinisë në Prishtinë dhe Komunës, dhe me ndërmjetësimin e Ministrisë, është arritur marrëveshja që Qendrës Rinore t' i mundësohet vazhdimi i kontratës mbi shfrytëzimin e objektit në Pallatin e Rinisë deri në muajin shkurt të vitit 2004. Mbetet një aktivitet shtesë i Ministrisë dhe i komunave në përgjithësi për të gjetur zgjidhje të qëndrueshme për të gjitha qendrat rinore në Kosovë.

Renovohet salla, hollit dhe hyrja e Kuvendit të Kosovës

Enterieri i Kuvendit të Kosovës po merr një pamje të re. Që nga fundi i korrikut të këtij viti punonjësit e firmës “Mabetex Group” kanë filluar punët për meremetimin e sallës, hollit dhe hyrjes së ndërtesës së Kuvendit të Kosovës. Renovimi i enterierit të ndërtesës së Kuvendit të Kosovës, pos tjerash përfshin instalimet elektronike, zërimin, nxemjen, klimatizimin dhe disa punë të tjera. Pritet që pas përfundimit të punëve të krijohen kushte optimale për punë për të gjitha organet e Kuvendit të Kosovës. Pos një pamje më të mirë, gjithsesi deputetët dhe punonjësit e Kuvendit të Kosovës do të kenë në dispozicion një ambient shumë më



Maketi i sallës së Kuvendit të Kosovës

funksional se deri më tash, në të gjitha segmentet e punës. Vështruar nga ana teknike, gjithë kjo do t' iu mundësojë deputetëve veprimtari sipas standard-

eve të parlamenteve evropiane e botërore. Sipas kontratës është paraparë që punimet, në kushte normale, të kryhen brenda 90 ditësh. Për kryerjen e këtyre punëve Kuvendi i Kosovës me kohë kishte shpallur tenderin, ashtu si parashohin dispozitat ligjore, ndërsa në tender kishin marrë pjesë firmat: “BRAND SRL” nga Italia, “Mabetex Group” nga Prishtina, “Lesna” nga Fushë - Kosova dhe “Bahler” nga Gjermania. Të themi se ofertuesve “Brand SRL” dhe “Lesna” ju kanë munguar propozimet teknike dhe financiare për hyrjen dhe hollin. Gjatë vlerësimit të ofertës është marrë parasysh kualiteti i ofertës për kryerjen e punimeve dhe çmimi i kostos.



Interior of the Kosovo Assembly